



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

RAPORT

**PËR PUNËN E ZYRËS SË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

**PËR PERIUDHËN
01.01.2023 – 31.12.2023**

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	6
1.1.	Vizioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përmbushje të veprimtarisë.....	6
II.	KUADRI LIGJOR QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË	7
2.1.	Referenca Ligjore.....	7
2.2.	Akte të miratuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	8
2.1.1	Organizim dhe funksionim:	9
2.1.2	Lidhur me veprimtarinë inspektuese:	11
III.	VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI DISIPLINOR DHE INSPEKTIMET	13
3.1.	Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	13
3.1.1	Të dhënat e ankuesit	14
3.1.2	Të dhëna për subjektin ndaj të cilit ngrihen pretendime	14
3.2.	Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave.....	15
3.3.	Hetimet Disiplinore	18
3.4.	Ankime kundër vendimeve të arkivimit dhe hetimit	20
3.5.	Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave.....	21
3.6.	Ecuria e trajtimit të ankesave backlog.....	23
3.7.	Inspektimet Tematike	24
3.7.1	Ecuria e inspektimeve tematike gjatë vitit 2023	24
3.7.2	Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve.....	28
IV.	BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR	30
4.1.	Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - KLGJ/KLP/KPK	30
4.2.	Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Prokurorin e Përgjithshëm	31
4.3.	Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë e Drejtësisë	31
4.4.	Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile	32
4.5.	Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë	34
4.6.	Zbatimi i rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, në kuadër të procesit për integrimin evropian	37
V.	ORGANIZIMI I BRENDSHËM	39
5.1.	Komandime nga KLGJ.....	39
5.2.	Komandime nga KLP	39
5.3.	Rekrutim i inspektorëve jomagjistrat	40

5.4.	Zbatimi i ligjit “Për shërbimin civil” në kuadër të plotësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore	41
5.5.	Procesi i vlerësimit të trupës së inspektorëve	43
5.6.	Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve	43
VI.	TË DHËNA MBI PROCESET GJYQËSORE KU INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ËSHTË PALË NDËRGJYQËSE	44
6.1.	Procese në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.....	44
6.1.1	Çështje të përfunduara	44
6.1.2	Çështje në proces shqyrtimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit	45
6.2.	Procese gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	45
6.3.	Procese gjyqësore të përfunduara apo në fazë gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.....	46
VII.	TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	48
7.1.	Qytetari në vëmendjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	48
7.2.	Qytetari si iniciues i inspektimeve tematike.....	48
7.3.	Pritja e qytetarëve në mjediset e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	49
7.4.	E drejta e informimit	50
7.5.	Komunikimi i targetuar publik.....	51
7.5.1	Faqja zyrtare e internetit.....	51
7.5.2	Komunikimi me masmedian.	52
7.5.3	Rrjetet sociale.....	52
7.6.	Edukimi ligjor si mënyrë direkte komunikimi	53
VIII.	PERFORMANCA FINANCIARE	55
IX.	PËRMBLEDHJE TË ARRITJEVE	57
X.	PRIORITETE GJATË VITIT 2024	59
XI.	NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2022.	60

MESAZH I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Ndarja me Kuvendin e ecurisë vjetore të punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një moment shumë i rëndësishëm për institucionin, sepse reflekton etapat e sfidave e të rritjes profesionale, por edhe të konsolidimit të praktikave të punës për të siguruar rezultatin maksimal, si pjesë e përpjekjes së përbashkët të të gjitha institucioneve për kthimin e besimit të publikut tek drejtësia, arsye për të cilën u konceptua reforma në drejtësi. Padyshim në këtë proces hasesh me pengesa, por diferencën e bën vullneti e përgjegjshmëria për të çuar përpara detyrën e për të ndërtuar një model pune me standarde, që do i rezistojnë viteve e do i shërbejnë sistemit dhe pasardhësve në këtë institucion.

Siç mund ta vini re në këtë raport, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka patur një vit intensiv pune, si në drejtim të funksionit kryesor, trajtimit të ankesave ndaj magistratëve dhe inspektimeve tematike, por edhe të finalizimit të stokut të ankesave e praktikave të mbartura nga institucione të mëparshme të procedimit disiplinor.

Trajtimi i ankesave të trashëguara, ka qenë një proces që ka tejkaluar ngarkesën normale të punës për burimet njerëzore në dispozicion, por në sajë të masave rregullatore, administrative dhe strukturore të ndërmarra, rezultatet janë të dukshme dhe të matshme. Evadimi i stokut të ankesave e kreu synimin e shpallur nga Zyra e ILD-së, se asgjë nuk harrohet dhe se shmangia e kulturës së pandëshkueshmërisë është një sinjal i qartë për të rritur besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

4 inspektime tematike të përfunduara deri në dhjetor 2023 dhe puna në proces e inspektimeve tematike të planifikuara pranë gjykatave dhe zyrave të prokurorisë është një tjetër bilanc për t'u shënuar. Synimi primar i këtyre inspektimeve tematike ka qenë konstatimi i problematikave në sistem dhe rekomandimi i zgjidhjeve, të cilat pritet t'i shërbejnë përmirësimit të punës së prokurorive dhe gjykatave, pa harruar edhe evidentimin, hetimin apo procedimin e shkeljeve disiplinore që shfaqen. Me kënaqësi konstatohet efekti pozitiv që kanë dhënë rezultatet e këtyre rekomandimeve, pasi nga monitorimi i zbatimit të tyre, organet e inspektuara kanë reaguar pozitivisht në adresimin e rekomandimeve duke marrë masa të karakterit administrativ dhe rregullator në funksion të përmirësimit të efikasitetit të veprimtarisë të organit të inspektuar.

Për të rritur maksimalisht efijencën e punës është bërë përcaktimi i kuadrit rregullator për shqyrtimin e ankesave dhe ndjekja e metodologjisë për shqyrtimin e tyre, sipas një radhe të diktuar nga kritere të qarta. Rikonceptimi strukturor dhe organizativ, për tre njësi të Zyrës së ILD-së, atë të *ndihmës inspektorëve*, duke rritur numrin e tyre për administrimit me efijencë të shërbimeve në mbështetje të veprimtarisë hetimore; të *njesisë për ankesat dhe marrëdhënies me publikun*, për të asistuar secilin prej ankuesve për mënyrën e paraqitjes së ankesës në ILD, e të kompetencave të institucionit në shqyrtimin e pretendimeve të tyre; në ngritjen e *një njësie të re* në funksion të realizimit me cilësi të proceseve të vazhdueshme në fushat e punës analizuese e kërkimore për standardizimin e procesit të punës dhe standardeve specifike me qëllim përcaktimin, përditësimin dhe analizimin e indikatorëve që matin performancën e institucionit në mënyrë periodike.

Fuqizimi i kapaciteteve të inspektimit përmes trajnimeve të inspektorëve tanë, falë bashkëpunimeve me homologët e vendeve të Bashkimit Evropian, por edhe angazhimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në iniciativa bashkëpunimi me BE-në, janë aspekte pune që na kanë shoqëruar gjatë vitit 2023, e po kthehen në praktikë të qëndrueshme pune.

Tradita e bashkëbisedimeve me nxënës, studentë, grupe të ndryshme shoqërore, edhe atje ku ata jetojnë e punojnë ka vijuar gjatë vitit 2023, në funksion të ndërgjegjësimit publik për rolin e funksionet e ILD-së, por edhe të edukimit ligjor.

Detaje dhe statistika të punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë paraqiten të detajuara në këtë raport, por çfarë konkludojmë si institucion është se pas 4 vitesh funksionim të ILD-së, përmes mekanizmave të inspektimeve tematike dhe shqyrtimit të ankesave të qytetarëve, sistemi i kontrollit të punës së magjistratëve po funksionon, *së pari* duke përcaktuar standarde të një sistemi funksional llogaridhënës, në përputhje me balancën që duhet të ekzistojë edhe me parimin e ndarjes së pushteteve, duke përcaktuar standarde për një sistem drejtësie të përgjegjshëm, të paanshëm dhe me integritet, dhe *së dyti* duke qenë kontribuues me mendime, sugjerime, rekomandime nëpërmjet inspektimeve tematike, për rritjen e performancës së sistemit të drejtësisë.

Me respekt,
Artur Metani
Inspektor i Lartë i Drejtësisë

I. HYRJE

1.1. Vizioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përmbushje të veprimtarisë

Vizioni i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, udhëhiqet nga parimet dhe vlerat e sistemeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, të tilla si ushtrimi i veprimtarisë në mënyrë të pavarur ndaj çdo lloj ndikimi duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe kompetencave të dhëna me ligj, ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të paanshme, të përgjegjshme, llogaridhënëse, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore, me efikasitet dhe profesionalizëm, të besueshme, transparente dhe të aksesueshme prej publikut, si dhe bashkëpunuese në nivel institucional.

Nën dritën e vizionit të veprimtarisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, drejton punën përmes këtyre objektivave të rëndësishme:

- Konsolidimi i veprimtarisë në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale;
- Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane;
- Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit;
- Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për qëllime të zbatimit në praktikë të objektivave të punës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar strukturën organizative të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, e cila është konceptuar për të funksionuar në respektim të parimeve të hierarkisë, llogaridhënies, ligjshmërisë, efektivitetit, paañsisë dhe mos diskriminimit si dhe të bashkëpunimit, në përmbushjen e misionit Kushtetues e ligjor për të arritur objektivat e sipërpërmendura.

II. KUADRI LIGJOR QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

2.1. Referenca Ligjore

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një organ i pavarur kushtetues, i ngritur në përputhje me nenin 147/d të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese sanksionon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Organizimi dhe funksionimi i institucionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rregullohet nga:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 536, datë 25.07.2019, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit”;
- Vendimi nr. 28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbështetet midis të tjerash në:

- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të

- detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
 - Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”;
 - Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar,
 - Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
 - Ligjin për buxhetin vjetor;
 - Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
 - Ligjin nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”;
 - Vendimin nr. 972, datë 02.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin të kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”;
 - Vendimin nr. 971, datë 02.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë”;
 - Vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme”.

2.2. Akte të miratuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në funksion të zbatimit të kompetencave ligjore, për nxjerrjen e urdhrave të përgjithshëm me natyrë administrative ose procedurale, janë hartuar dhe miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në total 35 urdhra të përgjithshëm me karakter administrativ dhe 6 vendime që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit¹.

Krahas urdhrave dhe vendimeve të përgjithshëm, janë hartuar edhe 5 vendime në funksion të miradministrimit të proceseve inspektuese si dhe 9 vendime ndryshuese të tyre.

Sa i takon urdhrave të përgjithshëm administrativ dhe vendimeve, ndër më të rëndësishmet, rendisim sipas kategorive:

- Organizim dhe funksionim
- Veprimtaria inspektuese

¹ Urdhrat janë të aksesueshëm në linkun: <https://ild.al/sq/legjislacion/akte/>

2.1.1 Organizim dhe funksionim:

1. Urdhër nr. 27, datë 20.02.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
2. Urdhër nr. 27/1, datë 20.02.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores “Për mbikëqyrjen e sjelljes nga grupi i punës për monitorimin e nëpunësve civilë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet vendore, Maj 2023”;
3. Vendim nr. 7, datë 24.02.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit vjetor të pranimit, për vitin 2023, për pozicionet pjesë e shërbimit civil, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
4. Urdhër nr. 33, datë 28.02.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
5. Vendim nr. 7/1, datë 24.03.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për përcaktimin e pozicioneve pjesë e shërbimit civil që do të shpallen për vitin 2023, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
6. Vendim nr. 13, datë 18.04.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, për vitin 2023”;
7. Urdhër nr. 43, datë 06.04.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për shpërndarjen e praktikave në proces trajtimi nga ana e inspektorit z. S. H.”;
8. Urdhër nr. 46, datë 24.04.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 33/1, datë 04.11.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e ndihmës inspektoreve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
9. Urdhër nr. 51, datë 16.05.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për shpërndarjen e praktikave në proces trajtimi nga ana e inspektorit znj. E.B.”;
10. Urdhër nr. 52, datë 16.05.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 119, datë 12.07.2021 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” të ndryshuar”;
11. Vendim nr. 53, datë 02.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në vendimin nr. 38, datë 02.10.2021 “Për miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve”, të ndryshuar;
12. Urdhër nr. 56, datë 26.05.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për llogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratëve që ushtrojnë veprimtarinë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
13. Urdhër nr. 57, datë 26.05.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 118, datë 30.12.2022 “Për ngritjen e komisionit të emërimit dhe vlerësimit, caktimin e anëtarëve të sekretariatit teknik dhe fillimin e procedurës së vlerësimit të inspektorëve për periudhën 2021-2023”;

14. Urdhër nr. 60, datë 31.05.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e formularëve të të dhënave statistikore të vlerësimit etik dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
15. Urdhër nr. 90, datë 03.08.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 123, datë 28.07.2021 “Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e dokumenteve administrativë që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””;
16. Urdhër nr. 94, datë 12.09.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për marrjen e informacionit periodik nga kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e zyrave të prokurorive lidhur me veprimtarinë gjyqësore dhe veprimtarinë e prokurorive”;
17. Urdhër nr. 95, datë 12.09.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 33/1, datë 04.11.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e ndihmës inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””, të ndryshuar;
18. Vendim nr. 53, datë 02.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në vendimin nr. 38, datë 08.06.2021 “Për miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve””, të ndryshuar;
19. Urdhër nr. 100, datë 02.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e formularit për regjistrimin dhe grumbullimin e informacionit statistikor lidhur me ankesat drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bazën e të dhënave nëpërmjet platformës office 365-aplikacioni list”;
20. Urdhër nr. 101, datë 02.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e formularit të ankesës, të ripunuar dhe udhëzimit për plotësimin e tij”;
21. Urdhër nr. 102, datë 02.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 9, datë 09.01.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për njësimin e dokumentit administrativ”;
22. Urdhër nr. 105, datë 05.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për regjistrimin e informacionit statistikor lidhur me ankesat drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në formularin e platformës office 365-aplikacioni list, për vitin 2023”;
23. Urdhër nr. 106, datë 05.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e formularëve statistikorë dhe metodologjinë e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit statistikor lidhur me ankesat/çështjet kryesisht drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
24. Urdhër nr. 107, datë 06.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e metodologjisë për analizën dhe raportimin e informacionit statistikor lidhur me ankesat/çështjet drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
25. Urdhër nr. 122, datë 06.11.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025”;
26. Vendim nr. 65, datë 09.11.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për procedurën e zgjedhjes, emërimit dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencave nga ana e Zëvendës Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
27. Urdhër nr. 110, datë 13.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për shpërndarjen e praktikave të inspektorit z. B. M.”;

28. Urdhër nr. 111, datë 16.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për shpërndarjen e praktikave në proces trajtimi nga ana e inspektor z. E. N.”;
29. Urdhër nr. 113, datë 24.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 33/1, datë 04.11.2022, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e ndihmës inspektoreve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar;
30. Urdhër nr. 120, datë 03.11.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për mënyrën e llogaritjes së pagës referuese bazë të magjistratëve që ushtrojnë detyrën në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
31. Urdhër nr. 122/1, datë 27.12.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për mënyrën e monitorimit, raportimit dhe zbatimit të planit të integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025”;
32. Urdhër nr. 137, datë 27.12.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e ndihmës inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar;
33. Urdhër nr. 134, datë 20.10.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit strategjik dhe planit të veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025”;
34. Urdhër nr. 134/1, datë 29.12.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për mënyrën e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të planit strategjik dhe planit të veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025”;
35. Urdhër nr. 136, datë 27.12.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për përbërjen e komisionit të emërimit dhe vlerësimit, caktimin e anëtarëve të sekretariatit teknik, miratimin e programit vjetor të vlerësimit dhe fillimin e procedurës së vlerësimit të inspektorëve”.

2.1.2 Lidhur me veprimtarinë inspektuese:

1. Vendim nr. 6, datë 24.02.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2023”;
2. Vendim nr. 6/1, datë 28.02.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata”;
3. Vendim nr. 6/2, datë 28.02.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive me objekt: “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori”;
4. Vendim nr. 6/3, datë 13.04.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për një ndryshim në vendimin nr. 6, datë 24.02.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2023””;
5. Vendim nr. 6/4, datë 13.04.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhomës Civile dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”;
6. Vendim nr. 6/5, datë 30.06.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022”;

7. Vendim nr. 6/6, datë 17.07.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6/4, datë 13.04.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhomës Civile dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë””;
8. Vendim nr. 6/7, datë 11.09.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6/1, datë 28.02.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata””;
9. Vendim nr. 6/8, datë 11.09.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6/2, datë 28.02.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive me objekt: “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori””;
10. Vendim nr. 58, datë 25.10.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1, datë 11.02.2020 “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht””, të ndryshuar;
11. Vendim nr. 6/9, datë 06.11.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6/1, datë 28.02.2023 “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata””, të ndryshuar;
12. Vendim nr. 6/10, datë 15.12.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6/1, datë 28.02.2023 “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata””, të ndryshuar;
13. Vendim nr. 6/11, datë 15.12.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6/2, datë 28.02.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive me objekt: “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori””, të ndryshuar;
14. Vendim nr. 6/12, datë 27.12.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për disa ndryshime në vendimin nr. 6/5 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022””.

III. VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI DISIPLINOR DHE INSPEKTIMET

3.1. Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Pjesës V, Kreu II, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Referuar veprimtarisë dhe në funksion të përmbushjes së parashikimeve të mësipërme ligjore, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2023, vihet re një numër në rritje ankesash të depozituara, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Gjatë këtij viti janë depozituar **879** ankesa të reja, të shpërndara sipas subjekteve ankuese janë:

- **831** ankesa të depozituara nga persona fizikë;
- **48** ankesa të depozituara nga persona juridikë.

Në mbyllje të vitit 2022 janë mbartur për trajtim **2824** ankesa, ku **1752** janë ankesa të depozituara pranë ILD-së dhe **1072** janë ankesa të fondit backlog. Objekt shqyrtimi për vitin 2023 në total janë **3703** ankesa, duke përfshirë dhe ankesat e depozituara gjatë këtij viti (879).

Nga këto ankesa, gjatë vitit 2023 janë shqyrtuar **2340** ankesa, nga të cilat **1268** janë ankesa të depozituara pranë ILD dhe **1072** janë ankesa të fondit backlog.

Tabela nr. 1 Të dhënat mbi ankesat për vitin 2023

Ankesa të depozituara gjatë vitit 2023	Ankesa të mbartura nga viti 2022	Ankesa Backlog të mbartura nga viti 2022	Ankesa objekt shqyrtimi gjatë vitit 2023	Ankesa të shqyrtuara gjatë vitit 2023	Ankesa të mbartura për vitin 2024
879	1752	1072	3703	2340	1363

Sipas të dhënave të ecurisë së shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, në përfundim të vitit 2023 rezultojnë se mbeten në proces **1363** ankesa, që do të mbarten për trajtim në vitin 2024.

Nga analiza statistikore për **195** ankesa është marrë vendim mbi verifikimin e tyre, të cilat janë ende në proces dhe meqenëse nuk kanë përfunduar, nuk janë përfshirë tek numri i ankesave të shqyrtuara për vitin 2023.

Rezultati i shqyrtimit të **2340** ankesave është si në vijim:

- **1616** ankesa të arkivuara pas shqyrtimit fillestar, ku **608** janë pjesë e fondit backlog;
- **707** ankesa të arkivuara pas verifikimit; ku **452** ankesa janë pjesë e fondit backlog;
- **17** ankesa të përfunduara me hetim disiplinor; ku **12** janë pjesë e fondit backlog.

Nga **2340** ankesa të shqyrtuara rezulton se:

- **2012** ankesa janë depozituar nga persona fizikë;
- **327** ankesa janë depozituar nga persona juridikë, përkatësisht:
 - **218** ankesa nga institucione publike;
 - **92** ankesa nga subjekte private;
 - **16** ankesa nga fondacione dhe organizata të shoqërisë civile;
 - **1** ankesë nga media;
- **1** ankesë anonime, pasi nuk evidentohet emri i ankuesit.

3.1.1 Të dhënat e ankuesit

Ankuesit të cilët i drejtohen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë një përfaqësim gjeografik nga i gjithë vendi, ku peshën më të madhe e ka qarku i Tiranës me 803 ankues (34% të ankuesve), ndjekur nga qarku Vlorë dhe qarku Durrës, respektivisht me 227 ankues (10%) dhe 199 ankues (8.5%). Ndërsa qarqet të cilat shënojnë numrin më të ulët të ankuesve janë qarku Dibër, qarku Berat dhe qarku Kukës, respektivisht me 46 (2%), 44 (1.9%) dhe 27 ankues (1.2%).

Nga analiza e informacionit lidhur me regjistrimin dhe trajtimin e ankesave, vihet re se 1326 ankues (81%) kanë depozituar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vetëm 1 ankesë, ndërsa 304 ankues (19%) kanë depozituar më shumë se një ankesë, për të njëjtin subjekt.

3.1.2 Të dhëna për subjektin ndaj të cilit ngrihen pretendime

Ankuesit kanë depozituar pranë Zyrës së ILD-së ankesa, duke ngritur pretendime ndaj subjekteve magjistratë gjyqarë dhe prokurorë. Nga 2340 ankesa të shqyrtuara, rezulton se pretendimet janë paraqitur në masën 68% për magjistratë gjyqarë, 7% për magjistratë prokurorë dhe 22% për gjyqarë dhe prokurorë së bashku. Për 77 ankesa nuk identifikohet subjekti ndaj të cilit ngrihen pretendime.

Nga informacioni statistikor i ankesave të shqyrtuara gjatë vitit 2023, vihet re se pretendimet ndaj magjistratëve gjyqarë që ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përbëjnë numrin më të lartë të ankesave. Ankesat për magjistratët e kësaj gjykate janë 15% e ankesave të shqyrtuara në total, ndjekur nga pretendimet ndaj gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me rreth 13%. Renditja vijon me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me rreth 6% të ankesave të shqyrtuara në total.

Arsyeja e përqendrimit të numrit më të lartë të ankesave në këto tre gjykata vjen si rrjedhojë e numrit të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin pranë këtyre gjykatave, numrit të lartë të çështjeve në shqyrtim, si dhe fillimit të funksionimit të hartës së re gjyqësore.

Më pas renditen Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me një përfaqësim prej rreth 5% secila.

Ndërkohë, për magjistratët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë paraqitur rreth 2% e ankesave të shqyrtuara në total.

Gjykatat me më pak ankesa ndaj magjistratëve të tyre janë: Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me rreth 1% secila.

Sa i takon ankesave të shqyrtuara, mbi pretendimet ndaj magjistratëve prokurorë, rezulton se për prokurorët që ushtrojnë detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është shënuar numri më i lartë i ankesave të ardhura, me rreth 6% e ankesave të shqyrtuara në total. Renditja vijon me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me rreth 2% secila. Për prokurorët e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) janë paraqitur rreth 1% e ankesave të shqyrtuara në total.

Numri më i ulët i ankesave është drejtuar për prokurorët që ushtrojnë detyrën në: Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me rreth 0.5% e totalit të ankesave të shqyrtuara secila.

3.2. Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të nenit 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrton fillimisht nëse ankesa është

ose jo e pranueshme, sipas kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të paragrafit 1, të nenit 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, verifikohet plotësimi i kriterëve të pranueshmërisë dhe brenda tre muajve nga depozitimi i ankesës, vendoset për arkivimin e saj, nëse një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës nuk përmbushen. Sipas nenit 122 të ligjit nr. 96/2016, për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit, duke kërkuar nga ankuesi dokumente dhe shpjegime shtesë për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar apo duke marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Në përmbushje të këtyre parashikimeve ligjore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë pas shqyrtimit të ankesave ka miratuar **1631** vendime, nga të cilat:

- **1061** vendime për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, të **1616** ankesave;
- **552** vendime për arkivimin pas verifikimit, të **707** ankesave;
- **16** vendime për hetim disiplinor pas shqyrtimit, të **17** ankesave;
- **2** vendime për hetim disiplinor të nisura me iniciativë nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nisur nga shqyrtimi i objektit të ankesave, rezultojnë se problematikat apo pretendimet e ngritura më së shumti nga ankuesit janë si më poshtë:

- Ankesa ndaj vendimmarrjeve të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve;
- Mos respektim të ligjit material dhe procedural nga ana e magjistratëve;
- Pretendime për zvarritje të gjykimit nga ana e gjyqtarëve por edhe zvarritje të e veprimtarisë hetimore nga prokurorët;
- Pretendime për vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Nga analizimi i fakteve, ligjit dhe arsyetimit të dhënë në vendim, ka rezultuar se shkaqet kryesore për arkivimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar të depozituara janë:

- Nuk konstatohet shkelje disiplinore;
- Subjekti nuk gëzon statusin e magjistratit.

Ndërkohë, arsyeja kryesore e arkivimit pas verifikimit të ankesave është se nuk ka fakte mjaftueshëm për të justifikuar fillimin e hetimit.

Referuar numrit të ankesave në të cilat evidentohet lloji i procesit gjyqësor rezultojnë këto të dhëna:

Tabela nr. 2 Numri i ankesave sipas llojit të çështjeve

Lloji i çështjeve	Numër ankesash
Çështje Civile	1044
Çështje Penale	879
Çështje Administrative	183

Praktikat e tjera të trajtuara i referohen informacioneve periodike të dërguara nga kryetarët e gjykatave (33 praktika), ndërsa për 201 ankesa nuk evidentohet lloji i procesit gjyqësor.

Nga vrojtimi i ecures së ankesave ndër vite, vihet re se numri total i ankesave për vitin 2023 ka patur një rritje me 90 ankesa më shumë, krahasuar me vitin pararendës.

Ndërkohë për ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2023, mbi bazë të grumbullimit të informacionit statistikor dhe analizimit të tij, vëmë re se:

- Është rritur numri i ankesave të paraqitura nga persona juridik, me 105 ankesa më shumë së viti pararendës, referuar:
 - numrit të ankesave të paraqitura nga institucione publike;
 - numrit të ankesave të paraqitura nga subjekte private;
- Është rritur numri i vendimeve të miratuara, me 395 vendime.

Gjatë vitit 2023, viti i katërt i funksionimit të ILD-së, numri i ankesave të shqyrtuara ka vijuar të mbetet i lartë. Një ndër faktorët kryesorë ka qenë trajtimi dhe përfundimi i ankesave të fondit backlog. Në të njëjtën kohë, është edhe tregues i pritshmërisë së lartë të publikut ndaj veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Duke vlerësuar të dhënat statistikore për numrin e lartë të ankesave që arkivohen dhe kryesisht ato që arkivohen për shkak se nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë, janë ndërmarrë masa për ndërgjegjësim, të cilat do të vijojnë edhe gjatë vitit 2024.

Në kuadër të rritjes së transparencës dhe ndërgjegjësimit të publikut, vijojnë veprimtaritë:

- publikimi i rezultateve të veprimtarisë së ILD-së, në kohë reale në faqen zyrtare në shqip dhe anglisht;
- komunikim publik jo vetëm përmes mediave, por edhe grupeve të ndryshme shoqërore në funksion të edukimit ligjor, sipas programit të posaçëm për informimin dhe komunikimin publik;
- informim sistematik i publikut përmes rrjeteve sociale mbi aktivitetin dhe funksionet e ILD-së, përmes prezantimeve të thjeshtuar;
- lidhja e memorandumeve me disa nga fakultetet e drejtësisë në vend;
- pritje e përditshme me qytetarët për dhënie informacioni apo sqarime të nevojshme për ankesat dhe rolin e ILD-së;
- publikim dhe përditësim të të dhënave të regjistrit të kërkesave për informacion;

- të dhëna statistikore dhe raporte të ndryshme.

Analiza periodike e informacionit statistikor do të vijojnë edhe gjatë vitit pasardhës dhe do të ndërmerren masa të vazhdueshme ndërgjegjësimi, për të sensibilizuar qytetarët se ankimi ndaj një magjistrati ndjek rregullat ligjore duke respektuar pavarësinë dhe paanësinë, e në të njëjtën kohë duke i shërbyer interesit publik, në respektim të plotë të shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike.

Ndërmarrja e këtyre masave, pritet të ketë ndikim dhe të japë rezultate në ndërgjegjësimin e opinionit publik, se roli i ILD-së është të vendosë ekuilibra të drejtë dhe të paanshëm, ndërmjet pretendimeve për cenim të interesave individuale të qytetarëve nga veprimtaria e magjistratëve dhe garantimit të pavarësisë dhe paanësisë së magjistratëve.

3.3. Hetimet Disiplinore

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në zbatim të neneve 123, pika 1 dhe 124, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin edhe me iniciativë, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

Referuar këtyre parashikimeve ligjore, gjatë vitit 2023 Inspektori i Lartë i Drejtësisë pasi konstatoi ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme, ka miratuar 18 vendime për hetim disiplinor, me anë të të cilave janë hetuar shkeljet e pretenduara ndaj veprimtarisë së 25 magjistratëve. Hetimi disiplinor për 23 subjekte ka filluar mbi bazë ankese dhe për 2 subjekte ka filluar me iniciativë.

Rezultatet e hetimit janë si vijon:

- për 6 magjistratë² (5 gjyqtarë dhe 1 prokuror) janë paraqitur pranë këshillave respektivë kërkesat për procedim;
- për 15 magjistratë (15 gjyqtarë) është mbyllur hetimi disiplinor për shkak të:
 - vlerësimit të fakteve, rrethanave të hetuara dhe provave të marra, si të pamjaftueshme për të provuar shkeljet e pretenduara;
- për 8 magjistratë (5 gjyqtarë dhe 3 prokurorë) të hetimit disiplinor, procedurat hetimore janë në proces.

Tabela nr. 3 Hetimet disiplinore për vitin 2023

2. Për 4 (katër) magjistratë procesi hetimor ka filluar në vitin 2022

Hetimet sipas subjekteve					
Numri i magjistratëve të hetuar	Prokurorë	Gjyqtarë	Hetime mbi bazë ankese nga fondi Backlog	Hetime mbi bazë ankese në ILD	Hetime me iniciativë të ILD
25	4	21	12	4	2

Hetimi disiplinor për 25 subjekte të hetimit disiplinor ka filluar pas dyshimeve të arsyeshme se shkelja e pretenduar mund të jetë kryer. Shkeljet disiplinore për të cilat Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor, lidhen me shkelje disiplinore në ushtrimin e funksionit, të cilat renditen:

- vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale, të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016;
- për veprim, mosveprim ose sjellje të magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin, të parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronja “dh” të 96/2016;
- mosparaqitje të kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme sipas ligjit, nëse magjistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla; të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar;
- shkelje të tjera³

Në krahasim me vitin 2022, numri i ankesave të shqyrtuara është përafërsisht i njëjtë, por referuar të dhënave të hetimeve, krahasimisht me një vit më parë, numri i hetimeve dhe numri i magjistratëve të hetuar është më i ulët. Numri i kërkesave për procedim mbetet i qëndrueshëm në raport me të dhënat e një viti më parë. Rezulton se edhe për këtë vit nuk ka asnjë vendim për mbyllje hetimi të ankimuar.

Hetimi disiplinor i realizuar nuk ka patur për qëllim ndëshkimin e magjistratëve, por shqyrtimin e interesave të ligjshëm të të dy subjekteve (ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është hetuar), duke gjykuar në mënyrë proporcionale dhe duke dokumentuar të gjitha provat dhe dëshmitë e paraqitura nga njëra anë dhe duke respektuar të drejtat e magjistratit objekt hetimi.

³ Të parashikuara nga:

Neni 102, pika 1, shkronjat, “b”, “ç”, “e”, “c”, të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar
Neni 140, pika 2, shkronjat “a”, “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

ILD për çdo rast të hetuar, ka kryer shqyrtimin e dokumentacionit, ka vlerësuar dëshmitë dhe ka qartësuar rrethanat që kanë diktuar nisjen e hetimit, në mënyrë që përfundimet e veprimeve hetimore të jenë të plota dhe të pakontestueshme. Kryerja e hetimeve, është realizuar në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me parimet e procedimit disiplinor, veçanërisht në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe hetimit sipas një procesi të rregullt ligjor.

Në rastet dhe në varësi të fakteve dhe provave të administruara, kur nuk janë vërejtur shkelje disiplinore hetimi është mbyllur.

Hetimi disiplinor si mjeti për të siguruar përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e magjistratëve është realizuar sipas standardeve ligjore dhe atyre institucionale të vendosura për të verifikuar në mënyrë të detajuar të gjitha pretendimet, edhe gjatë vitit 2023 ka patur në fokus cilësim të saktë të fakteve, vlerësimin e hollësishëm të provave dhe veprimeve, që lidhen me të dhënat e hetuara apo informacione në raport me shkeljen disiplinore.

Përgjegjshmëria dhe llogaridhënia e magjistratëve gjatë vitit 2023 nuk u kufizua vetëm me shqyrtimin e ankesave dhe hetimeve, por edhe me procese intensive inspektimi, të trajtuar me hollësi në pikën 3.7 të këtij raporti.

3.4. Ankime kundër vendimeve të arkivimit dhe hetimit

Bazuar në nenin 119, pika 4 dhe nenin 122, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankuesi ka të drejtën e ankimit në këshillin përkatës kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës. Neni 62, pika 13 dhe neni 160, pika 13 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikojnë respektivisht të drejtën për ankim ndaj vendimeve të arkivimit ose të pushimit/mbylljes së hetimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pranë Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankimeve, që ngrihet respektivisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Vendimet e Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankimeve janë përfundimtare dhe nuk mund të apeloohen para mbledhjes plenare të Këshillit.

Gjatë vitit 2023 ILD ka marrë 1622 vendime objekt ankimi pranë Komisioneve të Përkohshme të Shqyrtimit të Ankimeve, nga ku rezultojnë se kundër vendimeve janë depozituar:

- 60 ankime ndaj 1061 vendimeve të arkivimit pas shqyrtimit fillestar;
- 10 ankime ndaj 552 vendimeve të arkivimit pas verifikimit;
- asnjë ankim ndaj 9 vendimeve për mbylljen e hetimit disiplinor.

Nga 1622 vendime janë ankimuar vetëm 70 vendime arkivimi, ose shprehur në përqindje, janë ankimuar 4.3% e vendimeve të arkivimit. Ndërsa për 9 vendime për mbyllje të hetimit disiplinor

rezulton se nuk ka asnjë ankesë. Nga të gjitha ankimet e paraqitura rezultojnë 0 vendime të kthyer për shqyrtim.

Tabela nr. 4. Dinamika e ankimeve

Lloji i vendimit	Vendime objekt ankimi	Ankime ndaj vendimeve	Ankime ndaj vendimeve (%)	Vendime të kthyer për shqyrtim
Arkivim pas shqyrtimit fillestar	1,061	60	5.7%	-
Arkivim pas verifikimit	552	10	1.8%	-
Mbyllje hetimi	9	-	0%	-
Totali	1622	70	4.3%	-

Sikurse evidentohet më sipër, për vitin 2023 rezulton të ketë sërish një numër të ulët të ankimeve, në Komisionet e Përkohshme pranë Këshillave, ndaj vendimeve të ILD-së. Për të gjitha ankimet kundër vendimeve të arkivimit, rezulton se për të gjitha rastet Komisionet kanë vendosur refuzimin si të pabazuar të ankimit të paraqitur nga ankuesit ndaj vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e për pasojë asnjë prej vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk është cenuar.

Mjeti i ankimit në dispozicion të ankuesit dhe shqyrtimi i tyre nga komisionet përkatëse të parashikuara në ligj japin sigurinë dhe garantojnë se vendimmarrja e ILD-së është objekt shqyrtimi i ligjshmërisë në mënyrë të vazhdueshme. Nga rezultatet e ankimeve të viteve 2021-2022 dhe vitit 2023, rezulton se praktika e punës së ngritur dhe e ndjekur aktualisht nuk është cenuar nga organet kompetente për shqyrtimin e tyre.

3.5. Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas vlerësimit të provave të mbledhura dhe kur rezultatet e hetimit çojnë drejt përfundimit se ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, fillon procedimin disiplinor pranë Këshillave, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

Gjatë vitit 2023 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 6 magjistratë, për 5 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për 1 magjistrat kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor, bazuar në shkeljet disiplinore të parashikuara nga nenet 102 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neni 140 i “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” për shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si:

- Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;
- Veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;
- Veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale;
- Për rastet kur gjyqtari është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Për 5 kërkesat për procedim disiplinor të paraqitura në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar këto masa disiplinore:

- “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë së një vit”- 1 rast;
- “Vërejtje publike”- 2 raste;
- “Pezullim nga detyra për një periudhë prej dy vitesh”- 1 rast;
- “Shkarkim nga detyra”-1 rast.

Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, të gjitha kërkesat e paraqitura rezultojnë të jenë në fazë shqyrtimi nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor.

Për 1 kërkesë për procedim disiplinor të paraqitur në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar masën disiplinore “shkarkim nga detyra”. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë për këtë rast ka pranuar kërkesën për shkarkim nga detyra.

Tabela nr. 5 Dinamika e masave disiplinore të propozuara nga ILD për vitin 2023

Masa disiplinore e propozuar nga ILD	Numri i kërkesave për procedim disiplinor	Magjistratë të propozuar për masë disiplinore	Magjistrati	
			Gjyqtar	Prokuror
Shkarkim nga detyra	2	2	1	1
Pezullim nga detyra për një periudhë prej 2 vitesh	1	1	1	0

Ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se një vit	1	1	1	0
Vërejtje publike	2	2	2	0
Totali	6	6	5	1

Nga të dhënat për vitin 2023, për 1 kërkesë për marrje mase disiplinore të paraqitur në KLP, rezulton se kjo masë është pranuar duke mos u cenuar kështu ligjshmëria e hetimit dhe verifikimit të shkëljes. Procedimi disiplinor si momenti përmbyllës i veprimtarisë hetimore, ka rëndësi në drejtim të kontributit që ILD jep në përmirësimin e sistemit të drejtësisë, gjithashtu edhe në konsolidimin e veprimtarisë së tij kushtetuese.

3.6. Ecuria e trajtimit të ankesave backlog

Gjatë vitit 2023 për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë ka qenë prioritet përfundimi i shqyrtimit të ankesave të fondit backlog. Sikurse është paraqitur në raportin e veprimtarisë së vitit 2022, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e mbylli vitin me 1072 ankesa backlog në proces.

Tërësia e masave administrative dhe organizative që ka ndërmarrë Inspektori i Lartë i Drejtësisë për trajtimin e backlog-ut, kanë dhënë efektet e pritshme. Gjatë vitit 2023 u realizua me sukses trajtimi i të gjithë fondit backlog, ecuria e të cilit paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 6 Ecuria e trajtimit të backlog 2020-2023

Viti	Gjendja Backlog	Trajtuar	Mbartur për trajtim
2020	2,104	65	2,039
2021	2,039	433	1,606
2022	1,606	534	1,072
2023	1,072	1,072	-

Fondi backlog i trashëguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka filluar trajtimin në vitin 2020 me një numër total prej 2104 ankesash.

- Gjatë vitit 2020 - janë trajtuar 65 ankesa të këtij fondi, rreth 3% e totalit;
- Gjatë vitit 2021 - janë trajtuar 433 ankesa të këtij fondi, përkatësisht 21% e totalit;
- Gjatë vitit 2022 - janë trajtuar 534 ankesa të këtij fondi, përkatësisht 25% e totalit;
- Gjatë vitit 2023 - janë trajtuar 1072 ankesa të fondit backlog, pra rreth 51% e totalit.

Pra, në kuadër të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022”, duke u mbështetur në tërësinë e masave që

ka ndërmarrë, vihet re se Zyra e ILD-së gjatë vitit 2023 ka arritur të realizojë mbylljen e trajtimit të fondit backlog, të mbyllur plotësisht, dhe me shqyrtimin e mbi 50% të totalit të ankesave.

3.7. Inspektimet Tematike

3.7.1 Ecuria e inspektimeve tematike gjatë vitit 2023

Në mbështetje të nenit 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në objektin e veprimtarisë së tij, ndër të tjera kryen edhe inspektime institucionale dhe tematike, në lidhje me çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorive.

Për vitin 2023 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar planin e inspektimeve tematike me vendim nr. 6, datë 24.02.2023 “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2023”, të ndryshuar. Plani është hartuar, duke mbajtur në konsideratë:

- a) Detyrimet ligjore;
- b) Problematikat e evidentuara nga ankesat e paraqitura;
- c) Propozimet nga institucionet të cilave u është dërguar kërkesa për propozimin e inspektimeve tematike.

Në analizim dhe vlerësim të sa më sipër, është miratuar plani i inspektimeve, pjesë e të cilit janë këto tematika:

- “Ndarja e çështjeve me short, si edhe kontroll të raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2022-31.12.2022”;
- “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022”;
- “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2022-31.12.2022”;
- “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Civile dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për periudhën 01.09.2022-30.12.2022”.

Nga plani i inspektimeve për vitin 2023 është përfunduar:

1. Inspektimi me objekt: “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,

(Dhoma Civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë⁴”, për periudhën 01.09.2022-30.12.2022.

Ky inspektim tematik është iniciuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë duke marrë shkas nga numri i lartë i ankesave të paraqitura në ILD në të cilat janë ngritur pretendime për vonesa në zbardhjen e vendimeve gjyqësore përtej afateve ligjore ndaj magjistratëve gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile), si dhe ndaj magjistratëve gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Inspektimi tematik ka patur si qëllim krijimin e një panorame reale të gjendjes faktike të arsytimit dhe dorëzimit të vendimeve gjyqësore për çështjet civile dhe administrative të përfunduara në gjykatat e lartpërmendura, në funksion të respektimit të afateve procedurale.

Gjatë kryerjes së këtij inspektimi tematik ILD ka mbajtur në vëmendje ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrit të madh të çështjeve në pritje për t’u shqyrtuar në kuadër të vlerësimit të kohëzgjatjes së procedurave në lidhje me arsytimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore.

Duke mbajtur në konsideratë situatën konkrete të ngarkesës, organikës dhe numrit të magjistratëve, apo tipologjisë së çështjeve të gjykuara, me qëllim sigurimin e balancës së duhur mes nevojës për të arsytuar dhe dorëzuar të gjitha vendimet gjyqësore sipas afateve procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” nga njëra anë dhe mundësisë dhe kapaciteteve aktuale të Gjykatës së e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga ana tjetër si kohë e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsytuar, u vlerësua afati 120 ditor për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në përfundim të këtij inspektimi tematik ILD ka adresuar rekomandimet përkatëse për gjykatat subjekt inspektimi. Gjithashtu është vendosur:

- a) verifikimi kryesisht në kuadër të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për magjistratët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile), për vendimet e shpallura e të dorëzuara në sekretari pas 120 ditëve nga shpallja si dhe fillimi i verifikimeve për vendimet e shpallura, e të pa dorëzuara në sekretari deri në datën

⁴ Raporti është i aksesueshëm në linkun vijues: <https://ild.al/sq/2023/10/04/raport-i-inspektimit-mbi-proceduren-e-shpalljes-dhe-arsytimit-te-vendimeve-gjyqesore-te-gjykes-se-shkalles-se-pare-te-juridiksionit-te-pergjithshem-tirane-dhoma-civile-dhe-gjykes-administrat/>

15.05.2023.

- b) verifikimi kryesisht në kuadër të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për një magjistrat të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për vendimin e shpallur i cili është depozituar i arsyetuar në sekretari brenda 107 ditëve nga shpallja.

Afati për zbatimin e rekomandimeve është përcaktuar periudha 05.10.2023 e deri më datë 05.04.2024.

Për sa u takon rekomandimeve të lëna nga grupi i inspektimit, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, kanë nisur verifikimet e rasteve të përmendura në raportin e inspektimit.

Inspektim tjetër i përfunduar gjatë vitit 2023 edhe pse i planifikuar në periudhë tjetër, është:

2. Inspektimi me objekt: “Për kryerjen e inspektimit tematik në gjykata dhe zyra të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt: “Lirim me kusht””.⁵

Ky inspektim i filluar në vitin 2020 ka trajtuar kërkesat për “Lirim me kusht” nga ana e gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre, në lidhje me zbatimin e ligjit material/procedural në fuqi. Në kohëzgjatjen e këtij inspektimi tematik kanë ndikuar disa faktorë si: volumi i lartë i praktikave dokumentare të shqyrtuara, numri i lartë i gjykatave dhe prokurorive subjekt inspektimi, mungesa e inspektorëve në kohën e nisjes së tij dhe fluksit të backlog-ut, por edhe të ankesave të paraqitura drejtpërdrejt në ILD. Pavarësisht këtyre sfidave ky inspektim ka sjellë efekte të ndjeshme në kuadër të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së magjistratëve. Gjatë kryerjes së tij, siç është evidentuar dhe në raportin e punës së ILD-së për vitin 2022 janë hetuar dhe proceduar disiplinarisht disa magjistratë ndaj të cilëve Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka caktuar masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Këto masa disiplinore janë lënë në fuqi edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me vendimmarrje përfundimtare duke konfirmuar kështu standardin e punës së Zyrës së ILD-së. Përveç këtij rezultati në drejtim të identifikimit të përgjegjësive individuale të magjistratëve, ka patur një efekt të konstatuar në drejtim të përdorimit më të kujdesshëm të institutit të “lirimit me kusht” dhe rritje të cilësisë së vendimmarrjes.

Në përfundim të inspektimit janë hartuar disa rekomandime për prokuroritë dhe gjykatat përkatëse subjekt inspektimi, Gjykatën e Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës të cilat konkludojnë në:

⁵ Raporti është i aksesueshëm në linkun vijues: <https://ild.al/sq/2024/02/22/raporti-i-inspektimit-mbi-kryerjen-e-inspektimit-tematik-te-gjykatave-dhe-zyrave-te-prokurorive-prane-tyre-mbi-trajtimin-e-kerkesave-me-objekt-lirim-me-kusht/>

- nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për të siguruar zbatimin e njëjtë të ligjit dhe ndjekjes penale;
- unifikimi i praktikës së ndjekur nga prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm lidhur me caktimin e prokurorit përfaqësues të prokurorisë në gjykimet e kërkesave “lirim me kusht”, në drejtim të grupimit përkatës të prokurorëve midis të cilave do të zhvillohet procedura për shpërndarjen e kërkesave me objektin në fjalë;
- mbajtja e diskutimeve në mbledhjet e përgjithshme të gjykatave të problematikave të konstatuara në respektimin e ligjit material dhe procedural lidhur me trajtimin e kërkesave për “lirim me kusht”;
- unifikimin e praktikës gjyqësore për zhvillimin, njehsimin, ndryshimin në drejtim të kërkesave me objekt “lirim me kusht”, sa i takon:
 - o përcaktimit të periudhës kohore referuar datës së paraqitjes së kërkesës/datës së gjykimit që do të merret në konsideratë, për përlogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit për efekte të përfitimit të lirimit me kusht;
 - o përcaktimit të mënyrës së interpretimit të parashikimit të dispozitës 64/1 të Kodit Penal;
 - o përfshirjes e kohëzgjatjes së punës në përlogaritjen e masës së dënimit të vuajtur e cila i jep mundësi kërkuarit të përfitojë lirimi me kusht;
 - o interpretimit të kushtit ndalues “përsëritës” të parashikuar nga neni 64/3 i Kodit Penal, në këndvështrim të institutit të rehabilitimit referuara parashikimeve të nenit 69/a të Kodit Penal;
 - o përcaktimit të kohës së kushtit.
- njoftimin e organeve kompetente për vlerësimin etiko-profesional të magjistratit në drejtim të respektimit të ligjit material dhe procedural gjatë trajtimit të kërkesave me objekt “lirim me kusht”;
- trajnimin vazhdues të prokurorëve dhe gjyqtarëve në çështjet lidhur me zbatimin e legjislacionit material dhe procedural të institutit të “Lirimit me kusht” në drejtim të problematikave të evidentuara në:
 - o interpretimin e parashikimit të dispozitës 64/1 të Kodit Penal “*jo më pak se 2/3 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në 5 vjet burgim*” - “*jo më pak se 3/4 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni*” dhe në drejtim të shtrirjes së periudhës referuar kohës së paraqitjes së kërkesës;
 - o përfitimeve që përfshihen në përlogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit;
 - o kushteve ndaluese “*të mosqenurit përsëritës të të dënuarit për krime me dashje apo i dënuar për kryerjen e veprave penale të përcaktuara*”;
 - o interpretimin në mënyrë komplementare të parashikimeve të nenit 64 të Kodit Penal edhe për të dënuarit me burgim të përjetshëm;

- përcaktimi i kohës së kushtit.
- ndjekja në vazhdimësi e problematikave të evidentuara në zyrat e prokurorive në drejtim të të mos proceduarit me anë të shortit për caktimin e prokurorëve përfaqësues në gjykimin e kërkesave “lirim me kusht”;
- ndjekja në vazhdimësi e problematikave të evidentuara të mos përcaktimit të detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 60 të K.Penal, në rastet kur nga ana e gjykatës disponohet me pranimin e kërkesës “lirim me kusht”;
- vlerësimi i të dhënave lidhur me faktet që nëse provohen, përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuara sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas një raporti të veçantë të përgatitur hollësisht nga inspektorët sugjerohet:
 - fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor për disa magjistratë të zyrave të prokurorive dhe gjykatave objekt inspektimi, për periudhën e caktuar në raport.

Afati për zbatimin e rekomandimeve është përcaktuar për periudhën 01.04.2024-01.10.2024.

3.7.2 Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve

Gjatë vitit 2023 ka përfunduar monitorimi i zbatimit të rekomandimeve për dy inspektimet e përfunduara gjatë vitit 2022, konkretisht:

1. Inspektimi me objekt: “Respektimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, të ndryshuar.

Qëllimi i këtij inspektimi është evidentimi i mënyrës së interpretimit, respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, nga prokurorët. Në përfundim të inspektimit janë nxjerrë rekomandime për organet kompetente për të marrë masa me karakter rregullator, përmes ndryshimeve ligjore dhe nxjerrjes së akteve nënligjore në kompetencë të tyre për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”.

Njëkohësisht janë propozuar edhe masa të karakterit administrativ, duke propozuar sesione trajnimi për garancitë kushtetuese e konventore të lirisë personale, unifikimit të praktikave në të gjitha prokuroritë dhe rritjen e cilësisë së magjistratëve, përmes ofrimit të trajnimeve vazhduese.

Në kuadër të monitorimit gjatë vitit 2023, rezulton se organet objekt i këtij inspektimi kanë përmbushur rekomandimet e lëna në raportin e inspektimit.

2. Inspektimi me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar.

Ky inspektim ka patur qëllim zbatimin e urdhreve të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi ruajtjen e qëndrueshmërisë së organit të prokurorisë përmes kohezionit institucional dhe uniformitetit të veprimtarisë në të gjitha prokuroritë, në garantimin e pavarësisë funksionale të prokurorit në vendimmarrje për çështje konkrete.

Në kuadër të monitorimit gjatë vitit 2023, rezulton se organet objekt i këtij inspektimi kanë përmbushur rekomandimet e lëna në raportin e inspektimit.

IV. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi dhe forcimi i marrëdhënieve institucionale me organet e sistemit të drejtësisë dhe partnerët ndërkombëtarë, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë vijon të jetë një aspekt esencial për koordinimin e aktiviteteve në funksion të arritjes së qëllimeve të përbashkëta për konsolidimin e veprimtarisë së organeve të sistemit të drejtësisë dhe forcimin e besimit të publikut për veprimtarinë e ILD-së.

4.1. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - KLGJ/KLP/KPK

Sa i takon bashkëpunimit me Këshillat, përtej rekomandimeve të lëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022”⁶, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka trajtuar me prioritet dhënien e informacionit lidhur me ankimet e depozituara në Këshilla sa i takon vendimmarrjeve të ILD-së për arkivimet dhe mbylljen e hetimeve, informacion mbi të dhënat e ankesave të depozituara për magjistratët që janë në proces vlerësimi si dhe për ato që aplikojnë për ngritje në detyrë brenda sistemit të karrierës, si dhe çështje të tjera që lidhen me fushën e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

Për vitin 2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka administruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të dhëna të përditësuara për:

- Listat me emrat e magjistratëve të cilët ushtrojnë aktualisht detyrën;
- Listat e ish-magjistratëve të cilët nuk janë më pjesë e sistemit të drejtësisë;
- Shkëmbimi i informacioneve në kuadër të procesit të shqyrtimit të ankimeve ndaj vendimeve të arkivimit ose vendime të mbylljes së hetimit disiplinor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (17 raste);
- Shkëmbimi i informacioneve në kuadër të procesit të vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve me Këshillin e Lartë Gjyqësor (31 raste);
- Shkëmbimi i informacioneve në kuadër të procesit të vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve me Këshillin e Lartë të Prokurorisë (10 raste);

Nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë paraqitur për shqyrtim të mëtejshëm pranë Këshillave, rastet kur nga faktet e vlerësuara nuk justifikohet fillimi i procedimit disiplinor, por që janë të rëndësishme për vlerësimin etik dhe profesional.

Komunikimi me Këshillat është i vazhdueshëm për bashkërendimin e punës dhe shkëmbimin e informacionit në kohë dhe në cilësi.

⁶ Për më tepër mund të aksesoni: <https://ild.al/sq/2023/09/25/rezolute-e-kuvendit-per-vleresimin-e-punes-se-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë-per-vitin-2022/>

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për çdo vendimmarrje ndaj magjistratëve prokurorë apo gjyqtarë, ka shkëmbyer informacion, në kuadër të kërkesave të KPK-së në funksion të procesit të rivlerësimit. Ky komunikim ka vijuar për shkak të nevojave reciproke për informacion të përditësuar me qëllim rritjen e efikasitetit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në trajtimin e ankesave ndaj magjistratëve që janë në detyrë. Çdo komunikim që lidhet me referimet e KPK-së për verifikim ndaj veprimtarisë së magjistratëve edhe pse të konfirmuar në detyrë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar rastet duke kryer verifikimet e nevojshme.

Gjatë vitit 2023, bashkëpunimi me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, ka vijuar me shkëmbimin e informacionit në kuadër të procesit të rivlerësimit të magjistratëve gjithsej për **17** raste.

Sa i takon bashkëpunimit në kuadër të verifikimit të rasteve të përcjella për verifikim të mëtejshëm nga KPK-ja janë përcjellë 7 raste, 2 prej të cilave janë trajtuar me vendimet përkatëse. Gjithashtu gjatë vitit 2023, janë trajtuar me vendimmarrjet respektive edhe 7 raste të përcjella nga periudha të mëparshme.

4.2. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Prokurorin e Përgjithshëm

Bashkëpunimi me Prokurorin e Përgjithshëm, vijon në kuadër të angazhimeve të ndërsjella me nënshkrimin e memorandumit “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”. Gjithashtu në kuadër të procesit të hartimit të planit të inspektimeve për vitin 2023, ILD ka paraqitur kërkesë drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për të sugjeruar tematika në lidhje me inspektimet.

4.3. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë e Drejtësisë

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë ka vijuar me ofrimin e kontributeve, hartimin e raporteve dhe përcjelljen e informacioneve në ushtrim të kompetencave, sipas çështjeve të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale 2021-2025, planin e masave për zbatimin dhe monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit Evropian, lidhur me Kriterin Politik dhe Kapitullin 23, të *acquis* të Bashkimit Evropian.

Në veçanti gjatë vitit 2023, bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë ka qenë i përqendruar në koordinimin e punës dhe shkëmbimin e informacioneve, ndjekjen e takimeve në kuadër të hartimit të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, si dhe në kuadër të përmbushjes së angazhimeve për treguesit e kontratës Sektoriale, respektivisht Indikatorin 2, i cili rezulton

plotësisht i përmbushur nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në dëshmi të kësaj është disbursimi i fondeve të BE-së në buxhetin e shtetit në periudhën qershor 2023. Gjithashtu lidhur me ndërmarrjen e një angazhimi tjetër në kuadër të Indikatorit 7 të kësaj kontrate, duke marrë përsipër kryerjen e inspektimit tematik për dokumentimin nga ana e gjyqtarëve të informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim, për çështje civile të përfunduara, për periudhën 01.10.2023-31.12.2023.

Gjithashtu në kuadër të procesit të hartimit të planit të inspektimeve për vitin 2023, ILD ka paraqitur kërkesë drejtuar ministrisë për të sugjeruar tematika në lidhje me inspektimet.

Bashkëpunimi mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë gjatë vitit 2023, në kuadër të politikave shtetërore për sistemin e drejtësisë, është zhvilluar nëpërmjet një sërë raportimesh apo aktiviteteve të mbajtura në kuadër të këtyre raportimeve, konkretisht:

- kontribute periodike në kuadër të monitorimit të Kontratës Sektoriale “BE për reformën në drejtësi”;
- kontribute periodike në kuadër të monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit për Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025”;
- kontributi i Qeverisë Shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023;
- kontribut në kuadër të Nen komitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria;
- kontribut në kuadër të Progres Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023;
- kontribut për draftin Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës, Kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe fillimi i hartimit të Procesit Negociues”, për periudhën qershor-tetor 2023;
- kontribut në kuadër të monitorimit të Paketës Semestrare për Integrimin Evropian (PSIE) për periudhën korrik-shtator 2023” dhe monitorim për Paketën Semestrare të Integritimit Evropian (PSIE) 2023;
- kontribut në kuadër të procesit të hartimit të PKABE 2030 dhe PKIE 2024-2026.

4.4. Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile

Në funksion të transparencës dhe ndërgjegjësimit të publikut mbi misionin, kompetencat dhe përgjegjësitë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka krijuar një traditë të bashkëbisedimeve me grupe të ndryshme shoqërore, duke mbajtur komunikime edhe jashtë institucionit përmes edukimit ligjor.

Janë realizuar 12 aktivitete, ku përfshihen takime, konferenca e memorandume bashkëpunimi, ku janë përfshirë kategori të ndryshme shoqërore si nxënës, studentë e deri tek Organizatat e Shoqërisë Civile.

Aktivitetet janë fokusuar tek sistemi i drejtësisë dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut si për shembull: një aktivitet në qytetin e Bajram Currit ku është improvizuar një gjyq imitues nga nxënësit e shkollës 9 vjeçare “Besëlidhja e Malësisë”, leksione të hapura me studentë të Universitetit të Vlorës dhe Elbasanit, dega Drejtësi, bashkëbisedim me studentë të Akademisë “Citizen in charge” në Tiranë, të cilat kanë qenë të targetuara për nxitjen e edukimit ligjor, që nga sistemi parauniversitar deri në atë universitar.

Në funksion të synimit për të komunikuar me grupe interesi edhe nëpër rrethe, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar gjatë vitit 2023, dy tryeza bashkëbisedimi me Organizatat e Shoqërisë Civile në Lezhë dhe në Lushnjë, me mbështetjen e OSBE. Komunikimi i hapur në këto tryeza ka nxjerrë në pah rëndësinë që ka prezantimi dhe paraqitja e institucionit tek grupet e ndryshme të interesit, aty ku ata jetojnë dhe diskutimet mbi mënyrën se si e shohin rolin e institucionit, eksperiencat dhe pritshmëritë në raport me sjelljen e magjistratëve në sistem.

Po gjatë vitit 2023, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka qenë objekt analizash studimore profesionale nga Organizata të Shoqërisë Civile, që kanë në fokus të punës, monitorimin e sistemit të drejtësisë si për shembull Instituti për Studime Politike dhe Ligjore, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes dhe Infoçip përmes eventeve të posaçme, ku kanë paraqitur dhe diskutuar bashkë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, ecurinë e veprimtarisë së ILD-së, sfidat dhe përparimet, si dhe vizionin për të ardhmen.

Gjatë periudhës shkurt-korrik 2023, në kuadër të Projektit “Përmirësimi i performancës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si institucion kyç për një gjyqësor profesional në Shqipëri” zbatuar nga Qendra Evropiane, me mbështetjen e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) dhe financuar me fonde të Qeverisë Suedeze, është hartuar “Plan i Integritetit” dhe miratuar me urdhrin nr. 122, datë 06.11.2023, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025”.

Plani të Integritetit të Zyrës së ILD i shërben vlerësimit të:

1. cenimeve të integritetit për të gjitha proceset e punës në institucion, të cilët mund komprometojnë aftësinë e Zyrës së ILD-së për të kryer funksionin publik në mënyrë të paanshme, të përgjegjshme e profesionale dhe i faktorëve, që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara; si dhe formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre;
2. identifikimit, vlerësimit dhe parandalimit të tërësisë së rreziqeve, që cenojnë integritetin e institucionit dhe individëve që punojnë në të, si dhe është një dokument pune ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të institucionit;
3. konsolidimit të një sistemi të brendshëm të menaxhimit të integritetit për të eliminuar rrethanat dhe minimizuar rreziqet e sjelljeve jo etike, jo profesionale

- dhe veprimeve korruptive të të gjithë punonjësve të Zyrës së ILD-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre;
4. përmirësimit të rëndësishëm në mirëfunksionimin dhe mirëqeverisjen e institucionit.

4.5. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë

Në rrafshin e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë gjatë vitit 2023, janë realizuar disa aktivitete të rëndësishme, të cilat renditen si vijon:

Projekti “EU4Justice” – Support to strengthening the governance institutions of the judiciary in Albania IPA 2020. Projekt i BE-së, i cili është vijimësi e projektit “Euralius V”, me qëllim mbështetjen e zbatimit të reformës në drejtësi duke kontribuar në forcimin e institucioneve qeverisëse të drejtësisë objektivat e projektit janë:

- Përmirësimi i performancës së Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) në konsolidimin e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe funksionimit të gjyqësorit;
- Përmirësimi i mekanizmave të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) në përputhje me praktikat më të mira të BE-së.

Komponentët e lidhur me ILD-në, janë :

- Forcimi i funksionimit të ILD-së dhe konsolidimi i hetimit disiplinor bazuar në meritokraci dhe zhvillimi i procedurave transparente në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira (Komponenti 3);
- Sigurimi i koordinimit dhe koherencës së përgjithshme duke adresuar çështjet ndërsektoriale të rëndësishme për të gjitha institucionet e qeverisjes (Komponenti 4).

Për periudhën shtator – dhjetor 2023, janë realizuar disa aktivitete me ILD dhe përfituesit e tjerë të përfshirë në aktivitete me pikëprejje të përbashkët, konkretisht:

- Ngritja e një grupi pune me ekspertë ndërkombëtarë afatshkurtër dhe staf të ILD-së për të identifikuar dhe trajtuar sfidat dhe pengesat me të cilat është përballur procesi i trajtimit të ankesave, për të përmirësuar efikasitetin, efektivitetin dhe transparencën e procesit të trajtimit të ankesave, duke aplikuar standarde dhe procedura të unifikuara;
- Finalizimi i Strategjisë 2023-2025;
- Zhvillimi i tryezave të rrumbullakëta për identifikimin dhe adresimin e problemeve të përbashkëta të hasura gjatë procedimeve disiplinore.

Projekti - JustAl – Projekt i Asistencës Teknike për reformën në sektorin e drejtësisë në Shqipërisë, i cili mbështet zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Si pjesë e objektivit të përgjithshëm, për ngritjen e kapaciteteve për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të SND II. Ky projekt fokusohet gjithashtu në zhvillimin e kapaciteteve të stafit përkatës të MD-së, të institucioneve të varësisë dhe të institucioneve të tjera me qëllim të krijimit të mjeteve të përshtatshme të monitorimit dhe përmirësimit të raportimit aftësi të bazuara në tregues të veçantë. Objektiv i veçantë i këtij projekti është edhe mbështetja ndaj institucioneve të sistemit të drejtësisë për të zbatuar Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe planin e saj të veprimit.

Bashkëpunimi me këtë projekt ka konsistuar në rritjen e kapaciteteve të raportimit të stafit të institucioneve kontribuese në përmbushjen e objektivave specifik të përcaktuar në SND. Bashkëpunimi është realizuar përmes pjesëmarrjes së nëpunësve në takimin e punës me tematikë "Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet MD dhe institucioneve të varësisë si dhe institucioneve të pavarura të drejtësisë në lidhje me procesin e përgatitjes së Raportit të Monitorimit për periudhën janar – qershor 2023 mbi zbatimin e SND 2021 – 2025 dhe Planit të Veprimit të tij, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i mekanizmit raportues dhe përmirësimi i kapaciteteve raportuese të institucioneve të drejtësisë."

Aktualisht janë organizuar 4 takime pune në datat: 25 janar 2023, 6 mars 2023, 13 prill 2023 dhe 7 nëntor 2023.

Gjatë vitit 2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka nënshkruar gjatë një vizite pune në Athinë, një memorandum bashkëpunimi në respekt të interesit të përbashkët për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë. Ky memorandum parashikon bashkëpunimin mes palëve duke shkëmbyer informacione, praktika dhe përvoja në lidhje me të gjitha aspektet procedurale të kryerjes së një hetimi disiplinor dhe procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve⁷.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, gjatë vitit 2023, në vazhdimësi ka vijuar përpjekjet për të gjetur dhe mundësuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të kapaciteteve njerëzore. Thellimi i bashkëpunimit me RESIJ, si me konferencat e trajnimit, ashtu edhe materialet përgatitore për të prezantuar punën e ILD-së, kanë ndikuar në krijimin e partneritetit profesional ndërkombëtar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke shënuar një tjetër arritje të rëndësishme, atë të pranimit unanimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si anëtar me të drejta të plota në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ), gjatë Asamblesë së Përgjithshme të thirrur nga vendet anëtare datë 19.10.2023.

⁷ Memorandumi gjendet në linkun <https://ild.al/sq/2023/02/02/inspektori-i-larte-i-drejtësisë-nis-bashkëpunimin-me-keshillin-e-shtetit-te-greqisë/>.

Në kuadër të vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme në datë 19 tetor 2023, nën kujdesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe me pjesëmarrjen e delegacioneve të inspektorateve të Drejtësisë të Rumanisë, e cila mban presidencën e RESIJ, të Francës, Italisë, Belgjikës, Bullgarisë, Spanjës e Portugalisë, në Tiranë, në 14 dhjetor 2023, u mbajt për herë të parë Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ). Në Asamblenë e Përgjithshme të RESIJ, anëtarët miratuan ndryshimet finale në Statutin e Rrjetit, si dhe diskutuan mbi projektet e ardhshme të RESIJ. Gjatë Asamblesë së Përgjithshme u diskutua mbi projektet e të ardhmes dhe dinamikat e organizimit dhe funksionimit të Rrjetit përmes shkëmbimit dhe ndarjes së eksperiencës metodologjike të inspektimit dhe angazhimin në sfidat e përbashkëta si pavarësia e magistratëve dhe pritshmëria e publikut nga sistemi i drejtësisë.

Në 13 dhjetor 2023, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u bë pjesë e seminarit rajonal mbi proceset e hetimit dhe teknikat e intervistimit hetimor, i organizuar në Vjenë nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) me mbështetjen e Republikës Federale të Gjermanisë, me pjesëmarrjen e ekspertëve të zbatimit të ligjit e të drejtës penale nga Evropa Juglindore, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Turqia dhe Ukraina. Inspektorët e ILD-së bënë një paraqitje të rolit dhe funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe zhvillimin e hetimit disiplinor, në drejtim të procedurës së intervistimit të magistratëve, dëshmitarëve dhe çdo personi tjetër që mund të ketë informacion rreth fakteve objekt i hetimit disiplinor. Prezantimi i përfaqësuesve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përfshiu bazën ligjore dhe metodologjinë e parashikuar në legjislacionin shqiptar për zhvillimin e procesit të pyetjes.

Në 1 nëntor 2022, si pjesë e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ), Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka pranuar ftesën e Rrjetit për t'u angazhuar në projektin COPEIJ, të Komisionit Evropian "Për bashkëpunimin në mbrojtjen e mjedisit përmes autoriteteve kombëtare të inspektimit të drejtësisë", përkrah institucioneve homologe të Francës, Italisë, Rumanisë dhe Portugalisë, nën menaxhimin e *Expertise France*. Në këtë kuadër, anëtarë të Zyrës së ILD-së kanë marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e projektit të zhvilluara në periudhën shkurt-shtator 2023, që nga takimet koordinuese tek vizitat studimore, që janë kryer me rotacion në secilin nga vendet e projektit, e gjatë të cilave autoritetet kombëtare vendase, përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, kanë referuar praktikat e punës dhe sfidat si institucionale ashtu edhe ligjore. Në përfundim të kësaj faze, është hartuar raporti i punës në gjuhën frënge, me panoramën dhe rekomandimet për autoritetet kombëtare dhe Komisionin Evropian, për krijimin e mjeteve për reduktimin e hendekut mes nevojës për drejtësi penale efektive mjedisore dhe realitetit aktual në secilin vend⁸.

⁸ Ky raport gjendet i publikuar në linkun vijues: <https://ild.al/sq/2023/11/01/raport-kombetar-i-ild-bashkepunimi-per-mbrojtjen-e-mjedisit-nga-autoritetet-kombetare-te-inspektimit-te-drejtësisë-copeij/>

Në kuadër të vizitës zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm Francez të Drejtësisë në datat 01 – 02 Qershor 2023 me inspektorët, ndihmës-inspektorët, Kabinetin, Sekretarin e Përgjithshëm, dhe Drejtorinë e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është kryer trajnimi mbi inspektimet dhe metodikën e punës së shërbimit francez të inspektimit. Ky aktivitet është realizuar në kuadër të bashkëpunimit me RESIJ dhe me mbështetjen e CEPEJ, projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës për Drejtësinë.

Në 13 nëntor 2023 Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkë me krerët e disa organeve të pavarura zhvilloi një vizitë pune në SHBA, me ftesë të Open Gov Hub USA, së bashku me kolegë nga institucione të tjera të drejtësisë të Shqipërisë. Gjatë vizitës, u organizua event i publik me temë “Reforma në Drejtësi në Shqipëri, Konstitucionalizmi në Veprim”, mbi të cilën ndanë mendimet e tyre, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami dhe Kryetari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, z. Roland Ilia, të cilët më pas u përgjigjën pyetjeve të audiencës. Duke folur për gjetjen e ekuilibrit të duhur, midis një qeverisjeje të qëndrueshme, solide dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, z. Metani bëri krahasimin me mënyrën e punës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

4.6. Zbatimi i rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, në kuadër të procesit për integrimin evropian

Në Progres raportin e vitit 2023 të Komisionit Evropian, gjetjet për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, lidhen me shqetësimin për numrin aktual të inspektorëve, ku evidentohet se ILD ushtron veprimtarinë me gjysmën e numrit të inspektorëve të miratuar sipas strukturës organizative. Progres raporti i kushton rendësi rekrutimit në vijimësi të inspektorëve.

Pavarësisht këtij fakti në Progres raport evidentohet se ILD ka miratuar një metodologji për reduktimin e backlog-ut të trashëguar, nuk ka krijuar stok të ankesave të paraqitura që nga momenti i krijimit. Ka evidentuar të dhëna për numrin e ankesave të shqyrtuara, numrin e hetimeve të kryera dhe kërkesat për procedim. Gjithashtu dallohet fakti se Këshillat kanë marrë edhe masa të ndryshme, më të lehta nga propozimi i paraqitur nga ILD në kërkesat për procedim, konkretisht:

Në KLGJ janë paraqitur 3 kërkesa për procedim, dy prej të cilave janë në proces dhe një është mbyllur me vendim me një masë të ndryshuar nga ajo e propozuar.

Në funksion të adresimit të gjetjes në Progres raport, ILD ka përfunduar shqyrtimin e të gjitha ankesave backlog të trashëguara nga institucionet e mëparshme.

Sa i përket plotësimit të vendeve vakanteve për pozicionin “*Inspektor*”, ILD gjatë vitit 2023 ka drejtuar kërkesa për komandim në Këshilla (informacioni i detajuar gjendet në Kreun V të këtij raporti “Organizimi i brendshëm”).

Më datë 7 qershor 2023, në seancën dëgjimore mbi raportimin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka theksuar sërish kërkesën drejtuar anëtarëve të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut për mundësinë e vlerësimit të propozimeve për ndryshime ligjore, sikurse edhe në seancat dëgjimore të viteve 2021-2022.

V. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

5.1. Komandime nga KLGJ

Në plotësim të strukturës organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për plotësimin e strukturës organizative dhe veçanërisht Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë marrë disa masa, të cilat kanë patur si qëllim realizimin e komandimeve të magistratëve me profil gjyqtar. Në kuadër të kërkesës së paraqitur në vitin 2022 në Këshillin e Lartë Gjyqësor për komandim të 1 (një) magjistrati, gjyqtar, në pozicionin “*Këshilltar*” në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. 50, datë 27.01.2023 “Për komandimin e znj. A. Lika në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesa është miratuar.

Gjithashtu, në kuadër të plotësimit të vendeve vakante në njësinë e inspektorëve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur në Këshillin e Lartë Gjyqësor kërkesën për komandimin e dy magistratëve, gjyqtarë, në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pas konsultimit me informacionin e publikuar në faqen zyrtare të KLGJ-së, rezulton se me vendimin nr. 487, datë 21.09.2023 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”⁹, ka vendosur: “*Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për 2 (dy) pozicione të lira si inspektor*”. Në përfundim të kësaj procedure të publikuar nuk ka patur komandime nga KLGJ.

Nga ana tjetër, një inspektor magjistrat i komanduar në vitin 2020, me vendimin nr. 584, datë 18.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për përfundimin e afatit të komandimit si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ka përfunduar afati i komandimit dhe prej datës 01.12.2023, nuk ushtron detyrën e inspektorit.

5.2. Komandime nga KLP

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur kërkesë për komandimin e dy magistratëve, prokurorë, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në konsultim të faqes zyrtare të KLP-së, për sa i përket kërkesës së dërguar, në njoftimin e datës 20.10.2023 të mbledhjes plenare,

⁹ Këshilli i Lartë Gjyqësor (21.09.2023):“Njoftim për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. <https://klgj.al/ep-content/uploads/2023/09/NJOFTIM-P%C3%8BR-SHPALLJEN-E-K%C3%8BRKES%C3%8BS-P%C3%8BR-KANDIDATURA-NGA-RADH%C3%8BT-E-GJYQATAR%C3%8BVE-P%C3%8BR-KOMANDIMIN-N%C3%8B-ZYR%C3%8BN-E-INSPEKTORIT-T%C3%8B-LART%C3%8B-T%C3%8B-DREJT%C3%8BSIS%C3%8B.pdf>

KLP ka vendosur për mosmiratimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për hapjen e procedurës për komandim të prokurorëve,¹⁰.

KLP me shkresën e saj nr. 2007/1 prot., datë 30.10.2023, ka parashtruar argumentet për arsyet e mosmiratimit të kërkesës, pasi është në pamundësi për komandimin në ILD të prokurorëve përtej numrit tashmë të caktuar prej 5 prokurorësh.

Në referim të argumenteve të KLP-së për numrin e prokurorëve të komanduar në ILD, ka argumentuar se në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë komanduar gjithsej 5 (pesë) magjistratë prokurorë, 3 (tre) prej tyre kryejnë detyrën e inspektorit, 1 (një) magjistrat është në pozicionin e këshilltarit, ndërsa 1 (një) magjistrat ka qenë pezulluar nga detyra, për shkak të vendimit nr. 426, datë 27.07.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Gjatë viteve 2022 dhe 2023, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë efektivisht kanë ushtruar detyrën si inspektorë vetëm 3 (tre) magjistratë të profilit prokurorë.

Sikurse është parashtruar edhe në raportet e mëparshme të veprimtarisë, mungesa e inspektorëve magjistratë, është faktor me ndikim të lartë në ushtrimin e funksioneve. Jo pa arsye ligjvënësi ka parashikuar që përbërja e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nisur për nga rëndësia e funksioneve kushtetuese e ligjore, të jetë me magjistratë me përvojë të gjatë profesionale. Në vlerësimin tonë, përvoja profesionale ka qenë faktor pengues për interesimin e një numri më të gjerë magjistratësh që plotësojnë kriteret. Mosplotësimi i vendeve vakante, përbën cenim të realizimit të vetë procesit të hetimit disiplinor i cili ka në themel të tij rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe mbrojtjen e reputacionin të sistemit nga veprimet dhe aktet që cenojnë pozitën dhe figurën e magjistratit.

Numri i lartë i ankesave të paraqitura ndër vite dhe kërkesat në rritje për inspektime tematike, si kriter matës për performancën e sistemit të drejtësisë, kërkojnë angazhim të lartë të burimeve njerëzore nga njësia e inspektorëve. Problematika e plotësimit të vendeve vakante, për shkak të kriterëve ligjore, por edhe për arsye të tjera objektive me të cilat është përballur sistemi, mbeten shqetësim i mbartur ndër vite, të cilat për vitin e katër të veprimtarisë nuk kanë gjetur zgjidhje.

5.3. Rekrutim i inspektorëve jo magjistratë

Gjatë vitit 2023 nuk është shpallur asnjë pozicion për inspektor jo magjistrat.

¹⁰ Njoftimi mund të aksesohet në linkun vijues: <https://klp.al/2023/10/20/njoftim-per-media-mbi-seancen-plenare-date-20-tetor-2023/>

5.4. Zbatimi i ligjit “Për shërbimin civil” në kuadër të plotësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore

Me Vendimin e Kuvendit nr. 10/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në datën 16.02.2023, është miratuar struktura dhe organika e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ndryshimet strukturore kanë konsistuar në:

- Pakësimin e numrit të inspektorëve nga 26 inspektorë në 20 inspektorë, kjo për shkak të vështirësisë për plotësimin e vendeve vakante gjatë 2 viteve të funksionimit të ILD-së. Përvoja e deri tanishme ka treguar se kriteret ligjore për të qenë inspektor, vakancat në rritje të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, mungesa e interesit, nisur nga thirrjet e vazhdueshme të KLGJ për komandime, kanë treguar se plotësimi i numrit të përgjithshëm me 26 inspektorë, mund të mos arrihet. Po kështu edhe procedurat rekrutuese të ndjekura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, janë të gjata më shumë se një vit dhe nuk garantojnë plotësim të numrit brenda një kohe shkurtër. Të gjitha këto opsione janë vlerësuar si faktorë që ndikonin në ngadalësimin e përbushjes së veprimtarisë hetimore dhe inspektuese.
- Shtimin e numrit të ndihmës inspektorëve nga 17 në 23 ndihmës inspektor. Rritja e numrit të ndihmës inspektorëve do të krijojë mundësinë e rritjes së efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë mbështetëse për inspektorin. Duke krijuar mundësi që inspektori të ketë në fokus vetëm vlerësimin e veprimtarisë hetimore dhe inspektuese, për të cilën është përgjegjësi para ligjit.
- Është krijuar një strukturë e re, konkretisht Drejtoria e Analizës dhe Standardeve. Synimi kryesor për krijimin e kësaj drejtorie, është realizimi me cilësi i proceseve të vazhdueshme në fushat e punës analizuese e kërkimore për standardizimin e procesit të punës në çdo strukturë nëpërmjet përgatitjes së manualeve të brendshme dhe standardeve specifike me qëllim përcaktimin, përditësimin dhe analizimin e indikatorëve që matin performancën e institucionit në mënyrë periodike. Kjo strukturë do të mundësojë që raportet, analizat, informacionet etj., të shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim rritjen e eficiencës dhe uljen e çdo risku të mundshëm që ndikon në performancën e ILD-së, si dhe qëllimit të krijimit të tij, grumbullimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave statistikore me qëllim realizimin e raporteve me informacionin e nevojshëm lidhur me veprimtarinë e institucionit.

Gjatë vitit 2023, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kodit të Punës dhe ligjit organik, janë realizuar në total 23 emërim/rekrutime brenda strukturës së miratuar, 12 (dymbëdhjetë) lirime, si dhe 1 (një) pezullim statusi, si më poshtë:

1. Kabineti	3 (tre) këshilltarë, nga të cilët në një pozicion “Këshilltar” është komanduar një magjistrat me profil gjyqtar dhe 2 (dy) lirime (1 këshilltar dhe 1 sekretar i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë).
2. Inspektor Magjistrat	1 (një) për shkak të ngritjes në detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm).
3. Inspektor jo magjistrat	2 (dy) lirime me dorëheqje
4. Niveli i Lartë Drejtues	0 (zero)
5. Niveli i Mesëm Drejtues	7 (shtatë) emërimë (1 drejtor drejtorie lëvizje paralele dhe 6 ndihmës inspektorë, nga të cilët 4 pozicione janë plotësuar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe 2 pozicione me pranim nga jashtë shërbimit civil), 1 lirim (për shkak të lëvizjes paralele në institucion tjetër) dhe 1 pezullim statusi (për shkak të punësimit në pozicion jashtë shërbimit civil).
6. Niveli i Ulët Drejtues	4 (katër) emërimë (përgjegjës Sektor i Arkiv Protokollit, përgjegjës Sektor i Metodikës dhe Standardeve, përgjegjës Sektor i Shërbimeve të Përgjithshme, përgjegjës Sektor i Përfaqësimit dhe Raportimeve) dhe 2 lirime (për shkak të përfundimit të procedurave për ngritje në detyrë).
7. Niveli Ekzekutiv	9 (nëntë) emërimë, 1 (një) transferim i përkohshëm për nevoja të institucionit sipas ligjit nr. 152/2023 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe 4 (katër) lirime (nga të cilët 3 nëpunës për shkak të përfundimit të procedurave për ngritje në detyrë dhe 1 nëpunës për shkak të ristrukturimit).

Totali i emërimeve për vitin 2023 brenda strukturës së miratuar është 23 punonjës/nëpunës.

Numri i punonjësve sipas strukturës për vitin 2023 është 101 punonjës të miratuar.

Totali i punonjësve që ushtrojnë efektivisht detyrën është 80, prej të cilëve 4 janë inspektorë magjistratë dhe 7 inspektorë jo magjistratë. Në fund të viti 2023, vakancat e krijuara në njësinë e inspektorëve janë 10, ku 6 pozicione për pozicionin “inspektor” nga radhët e magjistratëve dhe 4 për pozicionin “inspektor” nga radhët e juristëve.

5.5. Procesi i vlerësimit të trupës së inspektorëve

Viti 2023, ka shënuar vitin e parë të fillimit të procesit të vlerësimeve të inspektorëve, duke mundësuar kështu vijimin e proceseve të tjera, si vijimi i procedurave për përzgjedhjen e inspektorëve të vlerësuar në funksione të rëndësishme që përcakton ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, procedurave të vlerësimit të magjistratëve të komanduar, apo të vlerësimit të aftësive për qëllime të karrierës së inspektorëve.

5.6. Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve

Gjatë vitit 2023, në drejtim të rritjes dhe kapaciteteve Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka maksimizuar përpjekjet për të gjetur dhe mundësuar zhvillimin profesional duke vijuar bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtarë për shkëmbimin e eksperiencave në fushën e hetimeve dhe inspektimeve.

Sa i përket veprimtarisë trajnuese, në muajin qershor 2023 nga Inspektorati i Përgjithshëm Francez i Drejtësisë janë zhvilluar trajnimet me tema: “*Kryerja e inspektimeve funksionale nga ana e IPD, metodologjia*” dhe “*Hetimet administrative ndaj magjistratëve : metodologjia*”, trajnime në të cilat kanë marrë pjesë Inspektorët, Ndihmës Inspektorët, Kabineti, Sekretari i Përgjithshëm, dhe Drejtoria e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Gjithashtu, në muajin Dhjetor 2023 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u bë pjesë e seminarit rajonal mbi proceset e hetimit dhe teknikat e intervistimit hetimor, i organizuar në Vjenë nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) me mbështetjen e Republikës Federale të Gjermanisë, me pjesëmarrjen e ekspertëve të zbatimit të ligjit të të drejtës penale nga Evropa Juglindore, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Turqia dhe Ukraina. Dy inspektorë (një inspektor magjistrat dhe një inspektor jo magjistrat) nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë bënë një paraqitje të rolit dhe funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe zhvillimin e hetimit disiplinor, në drejtim të procedurës së intervistimit të magjistratëve, dëshmitarëve dhe çdo personi tjetër që mund të ketë informacion rreth fakteve objekt i hetimit disiplinor.

Në kuadër të veprimtarisë trajnuese, nga nëpunësit civil të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë ndjekur një numër i konsiderueshëm trajnimesh të zhvilluara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për periudhën janar-dhjetor 2023 (41 trajnime).

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka treguar një vëmendje të veçantë, lidhur me rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke i dhënë prioritet zhvillimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, që nga krijimi i institucionit.

VI. TË DHËNA MBI PROCESET GJYQËSORE KU INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ËSHTË PALË NDËRGJYQËSE

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deri më 31 dhjetor 2023, ka marrë pjesë në proceset si më poshtë:

6.1. Procese në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

6.1.1 Çështje të përfunduara

- 1) Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 1/2022, datë 16.02.2022, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur në cilësinë e subjektit të interesuar bashkë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me kërkues magjistratin Sh. K., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec me objekt: “Shfuqizimi si një vendim në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 411, datë 17.12.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit Sh. K.” dhe deklarimin absolutisht të pavlefshëm të shkarkimit për shkelje të të drejtave të njeriut në procesin administrativ dhe për proces të parregullt ligjor, që bie ndesh me nenin 6 të KEDNJ dhe një sërë nenesh të Kushtetutës. Rivendosja e të drejtave të kufizuara prej kësaj vendimmarrjeje”. Në përfundim të gjykimit të këtij ankimi Kolegji i Posaçëm i Apelimit arriti në konkluzionin se masa disiplinore “shkarkim nga detyra” e dhënë ndaj magjistratit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është në përputhje me parimin e ligjshmërisë, e bazuar në kritere objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore, e bazuar në kriteret e individualitetit dhe të proporcionalitetit, dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e vetë ligjit. Me vendimin nr. 1, datë 20.02.2023, Kolegji i Posaçëm i Apelimit vendosi: mospranimin e ankimit të magjistratit Sh. K. kundër vendimit nr. 411, datë 17.12.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Sh. K., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec”.

Ky vendim është shpallur në datë 23.03.2023 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 54, datë 30.03.2023.

- 2) Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 2/2022, datë 20.06.2022, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur në cilësinë e subjektit të interesuar, bashkë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me kërkues magjistratin B. Z., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me objekt: “Ndryshimin e vendimit nr. 20, datë 31.01.2022, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit B. Z., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; Kthimin në detyrën e prokurores pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Dibër”. Në përfundim të gjykimit të këtij ankimi Kolegji i Posaçëm i Apelimit arriti

në konkluzionin se masa disiplinore “shkarkim nga detyra” e dhënë ndaj magjistrates nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është proporcionale me rëndësinë e shkeljeve të kryera prej saj.

Me vendimin nr. 2, datë 24.10.2023, Kolegji i Posaçëm i Apelit vendosi: mospranimin e ankimit të magjistratit B. Z. kundër vendimit nr. 20, datë 31.01.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistrates B.Z., prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër”.

Ky vendim është shpallur në datë 24.11.2023 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 175, datë 06.12.2023.

6.1.2 Çështje në proces shqyrtimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

- 1) Çështja e juridiksionit disiplinor nr. 4/2023, datë 03.11.2023, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur në cilësinë e subjektit të interesuar, bashkë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me kërkues magjistratin S. H. prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë me objekt: “Kundërshtimin e vendimit nr. 284, datë 17.07.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit S. H., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”. Çështja e juridiksionit disiplinor është në fazën e shqyrtimit në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

6.2. Procese gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

- 1) Çështje gjyqësore me palë paditëse: M. Z, S. M, L.Z, D.S etj; të paditur: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me objekt: “Detyrimin e të paditurve të rillogarisin dhe paguajnë diferencën e pagës së papaguar për periudhën 01.01.2019 e në vijim. Detyrimin e të paditurve të paguajnë 10 % interes ligjor mbi shumën e papaguar deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi. Shpenzimet gjyqësore, duke përfshirë dhe shpërblimin e avokatit, t’i ngarkohen palëve të paditura. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm”.

Kjo çështje është në gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilën nuk është caktuar data për shqyrtimin e saj.

6.3. Procese gjyqësore të përfunduara apo në fazë gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

- 1) Çështje gjyqësore administrative, e regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me palë paditëse: M. Z, S. M., L. Z., D. S. Etj., të paditur: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me objekt: “Detyrimin e të paditurve të rillogarisin dhe paguajnë diferencën e pagës së papaguar për periudhën 01.01.2019 e në vijim. Detyrimin e të paditurve të paguajnë 10 % interes ligjor mbi shumën e papaguar deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi. Shpenzimet gjyqësore, duke përfshirë dhe shpërblimin e avokatit, t’i ngarkohen palëve të paditura. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm”.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1862(80-2023-1900), datë 22.09.2023 ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kryejë pagesën e diferencës së pagës neto dhe interesave për paditëset znj. L. Z. dhe znj. D. S. si dhe dhënien e këtij vendimi me ekzekutim të përkohshëm”.*

- 2) Çështje gjyqësore administrative, e regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me palë paditëse: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, të paditur: Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me objekt:

- Shfuqizimin e vendimit të KLGJ-së nr. 19 prot., datë 25.04.2023 “Për refuzimin e ankimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, kundër vendimit nr. 312/1 prot., datë 30.01.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 312 prot., datë 30.01.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përsa u përket pretendimeve ndaj magjistratëve K. G. dhe A.M. dhe përfundimin për vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit, përsa u përket pretendimeve ndaj ish-magjistratit B. Q.”.
- Detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të marrë në shqyrtim dhe të zhvillojë hetime si dhe të shprehet me vendim përfundimtar mbi ankesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit”.

- 3) Çështje gjyqësore administrative, e regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, palë e paditur: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, me objekt: *“Shfuqizimin e vendimit administrativ nr.5213, datë 20.11.2023 të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë për “Dënimin me gjobë etj”.*

- 4) Çështje gjyqësore administrative, e regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse: E. A., palë e paditur: Inspektori i Lartë i

Drejtësisë, me objekt: *“Konstatimi i pavlefshmërisë së vendimit nr. 12, datë 15.03.2023, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për “Përfundimin e marrëdhënies në Shërbim Civil për znj. E. A.” ose Shfuqizimin e vendimit nr. 12, datë 15.03.2023, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për “Përfundimin e marrëdhënies në shërbim civil për znj. E. A. etj”.*

VII. TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

7.1. Qytetari në vëmendjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka reflektuar edhe gjatë vitit 2023, përgjegjësinë, si një nga institucionet e reja të qeverisjes së drejtësisë, për të ndihmuar në forcimin e besimit të publikut tek institucionet dhe sistemi i drejtësisë, duke ruajtur balancën mes interesit publik për administrimin e drejtësisë, me respektimin e pavarësisë së magjistratëve. Transparenca ndaj publikut dhe medias në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, por edhe në atë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në veçanti është kthyer në një nga momentet më të rëndësishme të punës së ILD-së, përmes një komunikimi të hapur publik.

Krahas veprimtarisë së përditshme funksionale të inspektimit, verifikimit, hetimit e procedimit disiplinor, ILD e ka fokusuar vëmendjen tek raporti me qytetarin, në dy dimensione:

- 1- Si ankues për shkelje disiplinore të pretenduara ndaj gjyqtarëve e prokurorëve,
- 2- Si qytetar i informuar, përmes aktiviteteve për edukim ligjor përgjatë gjithë vitit me grupe të ndryshme shoqërore.

Duke patur parasysh parimin se një qytetar i informuar arrin të adresojë aty ku duhet problematikën që has, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vijon të ndjekë një strategji komunikimi publik, që nis në institucion, me lehtësitë e krijuara për çdo ankues, përmes faqes së internetit, ku ndodhet një formular i dedikuar për t'u plotësuar, e më tej, çdo ditë, me pritjen dhe asistimin e qytetarëve, që duan të depozitojnë ankesë fizikisht, apo të marrin informacion për ecurinë e ankesës së tyre.

Që në fillimet e funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vëmendja ndaj qytetarëve/ankues ka qenë e lartë, si për ata që i janë drejtuar direkt ILD-së, por edhe për të tjerë, që ankesat e tyre i kishin depozituar prej vitesh në institucionet paraardhëse, të ngarkuara me procesin disiplinor të magjistratëve.

7.2. Qytetari si iniciues i inspektimeve tematike

Qytetarët ankues kanë shërbyer si iniciues të disa inspektimeve të ndryshme tematike, të Zyrës së ILD-së gjatë vitit 2023, konkretisht:

- ✓ Inspektimi tematik mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve të gjykatave, iniciuar nga shqyrtimi i një numri të madh ankesash mbi pretendimet për zvarritjen e gjykimit dhe vonesat në zbardhjen e vendimeve nga gjyqtarët. Ky inspektim u krye në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Tiranë, (Dhoma civile) dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe ka përfunduar.

- ✓ Inspektimi tematik me objekt: “Lirim me kusht”, i cili është iniciuar, që me nisjen punë të ILD-së, në vitin 2020, nisur nga ndjeshmëria e lartë publike në atë periudhë, pas lirimeve të disa personazheve të njohur për drejtësinë ka përfunduar në vitin 2023.

7.3. Pritja e qytetarëve në mjediset e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë


Krahas informimit dhe mundësisë së ankimit përmes faqes zyrtare të internetit, qytetarët apo subjektet mirëpritën çdo ditë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si për t’u informuar, ashtu edhe për të depozituar një ankesë, në rast nevojë me asistencën e ekipit të Sektorit të Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, që realizon pritje me qytetarët në çdo ditë zyrtare pune, nga ora 09.00-14.00, por edhe u përgjigjet interesimit të qytetarëve apo institucioneve përmes numrit zyrtar të telefonit.

Gjatë vitit 2023 janë asistuar dhe informuar nëpërmjet takimeve dhe linjës telefonike në lidhje me pretendimet/ankimet e tyre për magjistratët, mesatarisht (dy) qytetarë në ditë.

Konkretisht:

- Janë realizuar 241 takime me qytetarë, (mbi bazën e kërkesave me shkrim, të kërkesave më anë të komunikimit me telefon, si dhe pa përcaktim të mëparshëm). Gjatë takimeve, në çdo rast nëpunësit përgjegjës kanë dëgjuar pretendimet, duke i asistuar/informuar për paqartësitë, në lidhje me të drejtat e qytetarëve për t’u ankuar.
- Janë asistuar përmes telefonit, në numrin zyrtar të institucionit 188 qytetarë/subjekte të interesuar, të cilët kryesisht kanë kërkuar informacion mbi fazën në të cilën ndodhen ankesat, mënyrën se si pranohen, si procedohet me paraqitjen e dokumenteve shtesë në mbështetje të pretendimeve të tyre, etj.

Qytetarët e asistuar fizikisht dhe nëpërmjet numrit zyrtar të telefonit përgjatë vitit 2023



Gjatë vitit 2023 janë regjistruar edhe 350 vendime me shpallje, në zbatim të nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, si dhe janë konfirmuar më tej si shkresa nga bashkitë e vendit. Të gjitha vendimet me shpallje janë menaxhuar nga Sektori i Ankesave dhe një pjesë prej tyre, pavarësisht mungesës së ambienteve u publikuan në këndin e njoftimeve në hyrje të ILD.

7.4. E drejta e informimit

Edhe gjatë vitit 2023, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka përmbushur në çdo rast përpara afateve detyrimin ligjor, që rrjedh nga ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe nga miratimi i Programit të Transparencës të rishikuar. Është përditësuar sipas afateve regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve sipas urdhërimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Informacioni i bërë publik në programin e transparencës, pasqyron në mënyrë shteruese veprimtarinë e ILD-së, nëpërmjet publikimit të detajuar në faqen zyrtare ëëë.ild.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Programi i transparencës pasqyron në rubrika, tekstet/përmbajtjen, afatet për publikimin e informacionit, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon apo administron dokumentin.


Gjatë vitit 2023 pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 204 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda afateve ligjore. Kërkesat për informacion kategorizohen si më poshtë:

Viti 2023	
Kërkues	Numri i kërkesave për informacion
Persona fizikë	186
Media	8
Organizata të Shoqërisë Civile	2
Avokatë	5
Persona juridikë	2
OJF	1
Total	204

Asnjë kërkues nuk rezulton të jetë ankuar në autoritetet përkatëse për:

- a) mungesë informacioni;
- b) informacion të paqartë;
- c) tejkalim të afateve ligjore
- ç) refuzim të dhënies së informacionit.

Krahasuar me të dhënat e vitit paraardhës konstatohet se është në rritje numri i kërkesave për informacion. Duke e konsideruar tregues progresiv të rritjes së besimit të publikut tek institucioni, administrata e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ka trajtuar brenda një harku të shkurtër kohor kërkesat për informacion nga qytetarët, media, grupet e interesit apo organizatat e shoqërisë civile. Mesatarisht në javë, për vitin 2023 janë trajtuar katër kërkesa për informacion.



Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të vijojë të ruajë praktikën e mirë të krijuar tashmë në informimin publik, me vëmendje të posaçme në afatet e përcaktuara nga ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për dhënien e informacionit publik.

7.5. Komunikimi i targetuar publik

Në funksion të transparencës mbi veprimtarinë e institucionit, por edhe aksesin e publikut, edhe gjatë vitit 2023, në strategjinë e komunikimit të ILD-së janë përdorur mënyrat klasike të komunikimit, duke përmirësuar elementë për rritjen e efikasitetit të punës, në funksion të informimit mbi rolin dhe funksionet e ILD-së.

7.5.1 Faqja zyrtare e internetit

Faqja zyrtare e internetit dy gjuhëshe, shqip dhe anglisht (www.ild.al) është mjete kryesor zyrtar i komunikimit të ILD-së me publikun, në funksion të një marrëdhënieje proaktive dhe transparente.

Informimi përmes faqes bëhet pothuaj në kohë reale me veprimtarinë e institucionit, me rubrika të dedikuara mbi aktet, vendimet, procedurat e punës dhe aktivitetin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Faqja përmirësohet herë pas here në funksion të informimit

sa më shiterues, por edhe të thjeshtimit të përdorimit të saj nga çdo qytetar apo subjekt i interesuar, në kërkim të informacionit në kohë reale.

Kështu, rubrika “*Si pranohen ankesat*”, rifreskohet me raste konkrete orientuese për ankuesit mbi kushtet ligjore të pranueshmërisë së ankesës, ecurinë e saj, arkivimin, ankimin e deri tek hetimi e procedimi disiplinor, me një ilustrim grafik të të gjithë rrugëtimit që ndjek një ankesë në ILD. Ky informacion i përditësuar plotëson atë ekzistues për lehtësim të procesit të ankimit përmes formularit tip të ankesës, me udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij, një model tip të plotësuar orientues dhe mënyrat e dërgimit pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me e-mail, postë ose fizikisht.

“*Pyetje të shpeshta mbi procesin e ankimit*”, është rubrika e krijuar edhe në bazë të paqartësive të konstatuara nga komunikimet me qytetarë-ankues, si një element i shtuar i transparencës në informimin publik mbi procesin e ankimit në ILD, me përgjigje se si dhe ndaj kujt mund të ankohesh në ILD, si procedohet me ankesën, ecuria e saj etj.

Çdo të hënë, në faqe pasqyrohen *shifrat e përpunimit javor të ankesave* të depozituara, të proceseve të shqyrtimit, verifikimit, hetimit e procedimit disiplinor.

Edhe gjatë vitit 2023 “*Anketa mbi veprimtarinë e ILD-së*”, vijoi të përdorej nga qytetarët, si një mjet që institucioni e përdor për të marrë vlerësime mbi punën e vet, bazuar në eksperiencën e përvoja, mënyrën se si e kanë marrë informacionin, a janë asistuar në ankesën e tyre, etj.

Në harkun kohor të një viti janë plotësuar nga përdorues të ndryshëm 25 anketa online.

Buletini informativ edhe gjatë vitit 2023 ka vijuar të jetë një mënyrë sistematike komunikimi publik lidhur me aktivitetin mujor të institucionit, në shqip dhe anglisht.

7.5.2 *Komunikimi me masmedian.*

Edhe gjatë vitit 2023 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vijuar komunikimin e qëndrueshëm me mediat, si mënyrë për të arritur tek publiku, duke u përpjekur t’u përcjellë informacion në kohë reale mbi veprimtarinë e institucionit, duke iu përgjigjur interesimit mbi aspekte të ndryshme të punës së ILD-së, e duke i monitoruar, me qëllim vjeljen e informacionit mbi denoncimet e ndryshme për rastet e shkeljeve të pretenduara disiplinore të magjistratëve.

7.5.3 *Rrjetet sociale.*

Komunikimi përmes rrjeteve sociale ka patur vëmendje të shtuar gjatë vitit 2023, në kushtet kur ato janë kthyer në platforma informimi masiv për përdorues të çdo moshe. Përveç Twitter dhe YouTube, institucioni ka hapur mes vitin e kaluar një llogari në Facebook, me synim informimin e përdoruesve rreth rolit dhe funksioneve të Zyrës së ILD-së. Edhe pse faqja ka karakter vetëm informues, sektori i Ankesave dhe Marrëdhënive me Publikun që e administrojnë, u është përgjigjur kërkesave për asistencë nga qytetarë të ndryshëm, duke i orientuar bazuar në legjislativin përkatës.

7.6. Edukimi ligjor si mënyrë direkte komunikimi

Gjatë vitit 2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka intensifikuar praktikën e komunikimit me grupe të ndryshme shoqërore në funksion të edukimit ligjor mbi rolin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Zyrës së ILD-së dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë.

Edukimi ligjor përmes *medias* ka targetuar dinamikat që kanë patur në fokus sistemin e drejtësisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka kushtuar vëmendje të posaçme sqarimit publik mbi mënyrat se si aktivizohet Zyra e ILD-së për denoncimet publike, një proces që vijon edhe në vitin 2024. Në komunikimin publik Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka evidentuar detyrimin institucional për të bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me të dhëna apo informacione publike, në raport me shkelje të pretenduara disiplinore nga ana e magjistratëve, duke nënvizuar se interesi i publikut/*medias* për administrimin e drejtësisë, duhet të shkojë paralel me respektimin e pavarësisë së magjistratëve, si një balancë që i jep vlerë shtetit të së drejtës.

Pjesë e komunikimit publik përmes mediave ka qenë edhe sqarimi i metodikës së punës së ILD-së, në raport me trajtimin e ankesave, që bëhet sipas një radhe përparësie të bazuar në kritere si koha, tipologjia apo urgjenca e trajtimit, respektimi i parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe koha e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesës.

Edukimi ligjor ka targetuar edhe *kategori të tjera shoqërore*, pasi Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe ekipi i tij ka krijuar një traditë për paraqitjen e institucionit tek grupet e ndryshme të interesit, aty ku ata jetojnë, edhe jashtë kryeqytetit, përmes bashkëbisedimeve të hapura lidhur me rolin, veprimtarinë, por edhe objektin e punës së ILD-së, por edhe mënyrën se si shihet institucioni prej tyre. Në 12 takime e konferenca dhe memorandumë bashkëpunimi janë përfshirë kategori të ndryshme shoqërore, që nga *nxënës, studentë* e deri tek *Organizatat e Shoqërisë Civile*, të fokusuar tek sistemi i drejtësisë dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Po gjatë vitit 2023, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka qenë objekt analizash studimore profesionale nga Organizata të Shoqërisë Civile, që kanë në fokus të punës, monitorimin e sistemit të drejtësisë. Instituti për Studime Politike dhe Ligjore, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes dhe Infoçip përmes eventeve të posaçme, kanë paraqitur dhe diskutuar bashkë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, me profesionistë të fushës dhe përfaqësues institucionesh, ecurinë e veprimtarisë së ILD-së, sfidat dhe përparimet, si dhe vizionin për të ardhmen.

Ky proces komunikimi është pjesë e programit për informimin publik të planit vjetor të vitit 2023, ndjekja e të cilit bëhet nga Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun. Ky sektor përthith në mënyrë sistematike nevojat e konstatuara nga takimet fizike me qytetarët, komunikimi përmes linjës telefonike, si dhe të dhënat që janë mbledhur përmes ankesave, informacioneve të tjera dhe përmes rrugëve të informimit publik. Pjesë e strategjisë së

komunikimit të institucionit, informacioni i grumbulluar përkthehet në plane veprimi e aktivitete për të adresuar sfidat e konstatuara në drejtim të informimit të qytetarëve dhe sensibilizimin e tyre, bazuar në objektin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, planin strategjik, planin e integritetit etj.

Duke vendosur si prioritet kryesor të programit për edukimin, informimin dhe sensibilizimin e qytetarëve, transparencën ndaj publikut, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë punon sistematikisht për të rritur besimin tek çdo aktor publik, mediatik apo grup interesi.

VIII. PERFORMANCA FINANCIARE

Me ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u miratua një buxhet prej 288.4 milionë lekë, nga i cili:

1. Për shpenzime korrente 215.4 milionë lekë
2. Për investime 73 milionë lekë

Gjatë vitit 2023, buxheti i ILD pësoi ndryshime, e konkretisht:

➤ Për grupin e shpenzimeve korrente:

Në zbatim të ligjit nr. 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 325 të Këshillit të Ministrave dhe nr. 326 dt. 31.05.2023, nga Ministria e Financave u akorduan fonde shtesë për përballimin e efektit të rritjes së pagave të magjistratëve, të nëpunësve civil dhe atyre mbështetës me një total prej rreth 36.1 milionë lekë.

Gjithashtu, në zbatim të VKM nr. 929 datë 17.11.2010, të ndryshuar dhe VKM nr. 795 datë 28.12.2023, nga Ministria e Financave është akorduar fondi për shpërblimet e punonjësve për vitin 2023, në shumën totale prej 1.1 milionë lekë.

Me Aktin Normativ nr. 6, datë 14.12.2023, duke qenë se edhe për vitin 2023, mosplotësimi i vendeve vakante për pozicionet “Inspektor”, krijoi fonde të lira në zërat “Paga” e “Sigurime”, buxheti i ILD-së, u pakësua me 43.5 milionë lekë në këtë grup shpenzimesh.

Për sa i përket zërit “Shpenzime operative”, për shkak të planifikimit të ulët në fillim të vitit të fondit në vlerën 23.8 milionë lekë, u mundësua sigurimi i një fondi shtesë prej 10.5 milionë lekë, nga i cili 9.4 milionë lekë shtesë nëpërmjet transferimit nga fondet e kursyera në zërat “Paga” e “Sigurime”, dhe 1.1 milionë lekë shtesë e miratuar me Aktin Normativ nr.6, datë 14.12.2023.

Buxheti për Investimet sipas projekteve, i detajuar si më poshtë:

- Për projektin “Rikonstruksion i ambienteve të godinës së ILD-së”, në ligjin vjetor të buxhetit 2023, u planifikua fondi në vlerën 67 milionë lekë. Gjatë vitit 2023, për shkak të problematikave strukturore të evidentuara në objekt, u pezulluan punimet nga ana e kontraktuesit dhe u kërkua rishikimi i projekt preventivit të rikonstruksionit. Nisur nga mosrealizimi i fondit të miratuar, me Aktin Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 buxheti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u pakësua me 37 milionë lekë në këtë projekt investimi.

- Për blerjen e licencave për përdoruesit e sistemit të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve (SMAD), sistem i dhuruar nga projekti EURALIUS V në janar 2022, u realizua fondi i alokuar në shumën 5 milionë.
- Për vitin 2023, me buxhetin në dispozicion prej 1 milionë lekë, u realizua blerja e pajisjeve informatike të nevojshme për stafin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në mbyllje të vitit 2023, realizimi i buxhetit të rishikuar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas zërave të shpenzimeve dhe në total është si më poshtë:

<u>Zërat e shpenzimeve:</u>	<u>Plani</u>	<u>Realizimi</u>	
	<i>(000 lekë)</i>	<i>(000 lekë)</i>	<i>(% ndaj planit)</i>
1. Paga (600)	152,056	149,375	98.2%
2. Sigurime (601)	21,600	20,460	94.7%
3. Shpenzime operative (602)	34,270	32,322	94.3%
4. Të tjera korrente (606)	1,198	447	37.3%
5. Investime (230-231)	36,000	5,891	16.4%
TOTAL BUXHETI 2023	245,124	208,495	85.06%

IX. PËRMBLEDHJE TË ARRITJEVE

Prioritetet e vendosura për vitin 2023 dhe orientimi i punës, në drejtim të përfundimit të shqyrtimit të ankesave të backlog dhe rritjes së efikasitetit në drejtim të sigurimit të standardeve për të rritur përgjegjshmërinë e magistratëve dhe cilësinë e vendimmarrjes së tyre, kanë shënuar këto arritje:

1. Përfundimin e plotë të shqyrtimit të 2104 ankesave të trashëguara nga institucionet e mëparshme të procedimit disiplinor. Shqyrtimi i çdo ankesë, është realizuar në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit, për të siguruar nga njëra anë magistratët për realizimin e një procesi të rregullt, dhe nga ana tjetër për të ofruar sigurinë se të gjitha ankesat do të shqyrtoheshin për të shmangur pandëshkueshmërinë, duke ndikuar në rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Procesi i shqyrtimit të ankesave të trashëguara, ka qenë një proces që ka tejkaluar ngarkesën normale të punës, por në sajë të masave rregullatore, administrative dhe strukturore të ndërmarra, rezultatet janë të dukshme dhe të matshme. Përcaktimi i kuadrit rregullator për shqyrtimin e ankesave dhe ndjekja e metodologjisë për shqyrtimin e tyre sipas një rradhe të diktuar nga kritere të qarta. Rikonceptimi strukturor dhe organizativ, për tre njësi të Zyrës, (i) atë të ndihmësinspektorëve duke rritur numrin e tyre për administrimit me efikasitet të shërbimeve në mbështetje të veprimtarisë hetimore; (ii) njësisë për ankesat dhe marrëdhënies me publikun, për të asistuar secilin prej ankuesve për t'i shpjeguar mënyrën e paraqitjes së ankesës në ILD, si dhe kompetencat e këtij institucioni në shqyrtimin e pretendimeve të tyre, duke ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, për paraqitjen e ankesave në ILD; (iii) ngritjen e një njësie të re në funksion të realizimi me cilësi të proceseve të vazhdueshme në fushat e punës analitike e kërkimore për standardizimin e procesit të punës dhe standardeve specifike me qëllim përcaktimin, përditësimin dhe analizimin e indikatorëve, që matin performancën e institucionit në mënyrë periodike.

2. Përfundimi i dy inspektimeve tematike të planifikuara ka sjellë ndërgjegjësimin e magistratëve për kontrollin e veprimtarisë së gjykatave dhe zyrave të prokurorive objekt inspektimi dhe rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë. Nga inspektimet e përfunduara janë dhënë rekomandime të karakterit legjislativ, organizativ dhe të mirëfunksionimit. Rezultatet e këtyre rekomandimeve kanë dhënë efekt pasi nga monitorimi i zbatimit të tyre, organet e inspektuara kanë reaguar pozitivisht në adresimin e rekomandimeve duke marrë masa të karakterit administrativ dhe rregullator në funksion të përmirësimit të efikasitetit të veprimtarisë të organit të inspektuar.

Pas 4 vitesh të funksionimit të ILD-së, përmes mekanizmave të inspektimeve tematike dhe shqyrtimit të ankesave të qytetarëve, mund të themi me bindje se sistemi i kontrollit të punës së magistratëve, po funksionon. *Së pari* nëpërmjet përcaktimit të standardeve të një sistemi

funksional llogaridhënës, i cili garanton balancën e drejtë ndërmjet parimit të pavarësisë dhe ndarjes së pushteteve nga njëra anë dhe ngritjes së një sistemi drejtësie të përgjegjshëm, funksional dhe me integritet nga ana tjetër dhe *së dyti* duke qenë kontribues me mendime, sugjerime, rekomandime nëpërmjet inspektimeve tematike, për rritjen e performancës së sistemit të drejtësisë.

3. Viti 2023, ka shënuar fillimin e procesit për vlerësimin etiko-profesional të inspektorëve, duke përfunduar vlerësimin për 1(një) inspektor dhe vijimin e punës për vlerësimin e inspektorëve të tjerë. Ky proces hap rrugën për ngritjen e komisioneve përkatëse për vlerësimin e inspektorëve, emërimin e inspektorëve jo magjistratë, procedimin disiplinor, apo dhe zgjedhjen e Zëvendës Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kjo për shkak të kriterëve që duhet të plotësonin inspektorët, veçanërisht lidhur me përvojën në detyrë si inspektor apo magjistrat, të vlerësuar sipas kriterëve të vlerësimit etik dhe profesional, si parakusht për të qenë pjesë e këtyre organizimeve kolegjiale.
4. Përmirësimi i efencës nëpërmjet digjitalizimit, duke qenë proaktivë në procese bashkërenduese me organet e tjera të drejtësisë, për vënien në zbatim të një sistemi elektronik, për ekonomizimin e kohës së shqyrtimit të ankesave, marrjen e të dhënave nga gjykatat dhe prokuroritë në kohë reale, gjenerimin e të dhënave dhe raporteve të ndryshme, duke thjeshtuar procedurat dhe efektivitetin në punë.
5. Krijimi i partneritetit profesional ndërkombëtar, duke shënuar një tjetër bashkëpunim të rëndësishëm, atë të pranimit unanim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si anëtar me të drejta të plota në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ), gjatë Asamblesë së Përgjithshme të thirrur nga vendet anëtare datë 19.10.2023. Si anëtar i RESIJ, ILD është bërë pjesë e projektit “Bashkëpunimi për Mbrojtjen e Mjedisit nga Autoritetet Kombëtare të Inspektimit të Drejtësisë” (COPEIJ) projekt i porositur nga Komisioni Evropian e që finalizohet në Maj 2024.
6. Forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në drejtim të rritjes dhe forcimit të integritetit, përmirësimin në mirëfunksionimin, mirëqeverisjen e institucionit, rritjen e ndërgjegjësimit të fushave me risk të lartë dhe adresimin e zgjidhjeve të planifikuara.
7. Vlerësimi nga ana e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për zbatimin e Programit të Transparencës sipas të gjithë indikatorëve të tij, duke e klasifikuar ILD-në si institucion me transparencë proaktive

të lartë¹¹.

X. PRIORITETE GJATË VITIT 2024

1. Konsolidimi i veprimtarisë në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale, përmes adresimit të masave për plotësimin e vendeve vakante, paraqitjes së kërkesave buxhetore, krijimit të kushteve të punës dhe matjes së performancës së njësive dhe vlerësimit të inspektorëve.
2. Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë, përmes krijimit të një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë, duke shqyrtuar objektivisht ankesat dhe kryerjen e inspektimeve tematike.
3. Forcimi i kapaciteteve profesionale për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të magjistratëve, subjekte të procedimit disiplinor.
4. Ngritja e një sistemi efektiv të teknologjisë së informacionit për menaxhimin elektronik të çështjeve.
5. Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke publikuar raporte dhe informacion të përditësuar.
6. Zhvillimit të aktiviteteve me funksion ndërgjegjësues, për rolin dhe funksionet e ILD-së.
7. Ndjekja dhe zbatimi i masave për të parandaluar cenimin e integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

¹¹ Informacionin e gjeni tek Indeksi i transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë të Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale [https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/2023 Indeksi i transparencës autoritete qendrore varesia.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/2023%20Indeksi%20i%20transparencës%20autoritete%20qendrore%20varesia.pdf)

XI. NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2022.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në respektim të vendimeve nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj” dhe nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, si dhe bazuar në ecurinë e punës së ILD-së, ka bërë një vlerësim të detajuar të raportit vjetor të punës të depozituar pranë tij nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për periudhën janar-dhjetor 2023.

Në seancën plenare të datës 06 korrik 2023, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rezolutën “Për vlerësimin e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2022”, përmes së cilës janë lënë për ndjekje dhe zbatim 7 rekomandime.

Me miratimin e rezolutës, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është hartuar kalendari i masave për zbatimin e rekomandimeve, janë caktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e masave për secilin rekomandim dhe afatet përkatëse për përmbushjen e rekomandimeve.

Nga rekomandimet e lëna sipas rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në një sintezë të nivelit të zbatimit të tyre, vëmë në dijeni se:

- prej tyre janë përmbushur rekomandimet nr. 1, 2, 6 dhe 7;
- rekomandimet e tjera, 3, 4 dhe 5 janë realizuar pjesërisht dhe mbeten në proces për realizimin gjatë vitit 2024, pasi zbatimi i tyre është i lidhur me veprimtari që ndiqen në bashkëpunim me organe të tjera.

Për sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve dhe masave të marra në zbatim të tyre, në mënyrë të detajuar informojmë sa vijon:

1. Përmbyllja brenda vitit 2023 të trajtimit të ankesave të dorëzuara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare”.

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi ILD, me miratimin e metodologjisë së trajtimit të ankesave gjatë vitit 2021 dhe monitorimit të zbatimit të saj mbi baza periodike javore të ecurisë së trajtimit të ankesave backlog, rezulton se nga ana e ILD-së trajtimi ankesave të dorëzuara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare (backlog- 2104 ankesa) është realizuar plotësisht.

2. *Fillimin sa më shpejt të vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve në funksion të kryerjes së kontrollit të brendshëm periodik.*

Në funksion të këtij rekomandimi ILD, janë ndërmarrë masat si më poshtë:

1. Ngritjen e Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit;
2. Thirrjen e mbledhjes së parë, konstituimin e KEV;
3. Realizimin e procedurave për vlerësim, sipas akteve të miratuara;
4. Hartimi i raportit të vlerësimit.

Në zbatim të këtyre masave me urdhrin nr. 118, datë 30.12.2022 “Për ngritjen e Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit, janë caktuar dhe emëruar anëtarët e Sekretariatit Teknik, dhe vendosur fillimi i procedurës së vlerësimit të inspektorëve”, është ngritur Komisioni i Emërimeve dhe Vlerësimit (KEV), i cili më datë 31.05.2023 ka mbajtur mbledhjen e parë të konstituimit të tij, shortimin e përzgjedhjen e relatorit të dosjes së vlerësimit dhe dakordësimi i programit të vlerësimit.

Më datë 31.05.2023, është mbajtur mbledhja e parë e KEV-it, në kuadër të së cilës është diskutuar programi i vlerësimit dhe është vendosur për vijimin e vlerësimit të një inspektori magjistrat, për periudhën 13.02.2020-31.12.2022. Më tej është zhvilluar shorti për përzgjedhjen e relatorit për të realizuar procedurën e vlerësimit, duke vijuar me nxjerrjen e vendimit nr. 16, datë 31.05.2023 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etiko-profesional të inspektorit magjistrat M.P., për periudhën 13.02.2020-31.12.2022.

Me miratimin e vendimit nr. 16, datë 31.05.2023 të KEV, është njoftuar inspektori për fillimin e procedurës dhe janë administruar korrespondencat përkatëse në funksion të realizimit të procedurës së vlerësimit. KEV me marrjen në dorëzim të dokumentacionit, ka miratuar raportin e vlerësimit me vendimin e tij nr. 66, datë 24.11.2023. Sipas programit, KEV do të vijojë me vlerësimin e inspektorëve të tjerë të përcaktuar në program.

3. *Vijimin me ritme të shpejta të zhvillimit të sistemit të teknologjisë së informacionit dhe strategjisë së menaxhimit të rasteve në përmbushje të detyrimeve ligjore.*

Në funksion të këtij rekomandimi ILD ka ndërmarrë disa masa, të cilat synojnë zhvillimin e sistemit të brendshëm për menaxhimin e ankesave/çështjeve që shqyrtohen nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke ngritur një platformë elektronike për regjistrimin e informacionit statistikor të ankesave të ardhura në ILD. Për këtë qëllim janë hartuar dhe miratuar urdhrat përkatës të cilët janë të aksesueshëm në linkun vijues: <https://ild.al/sq/legjislacion/akte/>. Në zbatim të urdhrave, janë duke u plotësuar të dhënat e nevojshme për grumbullimin, përpunimin dhe analizimin e informacionit statistikor, për vitin 2023.

Në kuadër të ecurisë së punës pranë Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për organet e sistemit të drejtësisë, ka filluar puna për hartimin e udhërrëfyesit për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Në zbatim të vendimit nr. 5, datë 15.06.2023, të Bordit Drejtues të QTI-së "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e udhërrëfyesit për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri", janë caktuar anëtarët për të marrë pjesë në grupin ndërinstitucional të punës për hartimin dhe miratimin e Udhërrëfyesit për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë. Sa i takon hartimit dhe miratimit të Udhërrëfyesit, nën koordinimin e QTI-së dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve në grupin ndërinstitucional të punës për hartimin e udhërrëfyesit për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë, është duke u punuar sipas udhëzimeve dhe orientimeve që vijnë nga ekspertë të huaj, të caktuar nga delegacioni i BE-së për të asistuar KLGJ-në dhe QTI-në për hartimin e udhërrëfyesit. Nga ana e QTI-së, puna është organizuar duke vijuar me konsultim me institucionet përkatëse pjesë e ICMS për llojin e të dhënave si dhe mënyrën e sigurimit të tyre nëpërmjet takimeve, shkëmbimit të informacionit, komunikimit zyrtar, është hartuar drafti i parë i cili është në konsultim ndërmjet anëtarëve të grupit të punës.

Në lidhje me masa konkrete për ILD-në, në këtë grup pune është kërkuar të përcaktohet rrjedha e proceseve të punë (*workflow*) dhe identifikimi i institucioneve me të cilat ILD do të ndërveprojnë nëpërmjet sistemit elektronik. Ky proces pune ka përfunduar dhe është për shqyrtim në QTI.

4. *Vijimin dhe përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi janë hartuar kërkesat për komandimin e magjistratëve drejtuar:

1. KLGJ (nr. 2459/1 prot., datë 31.07.2023), për dy magjistratë;
2. KLP (nr. 2459 prot., datë 31.07.2023), për dy magjistratë.

Nga kërkesat e paraqitura pranë KLGJ-së, kjo e fundit ka proceduar me njoftimin për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për 2 (dy) pozicione të lira si inspektor”, në datë 21.09.2023. Nga konsultimi me faqen zyrtare të KLGJ, nuk ka informacion mbi vijueshmërinë e këtij procesi¹².

¹² Njoftimi mund të aksesohet në linkun vijues: <https://klgj.al/ep-content/uploads/2023/09/NJOFTIM-P%C3%8BR-SHPALLJEN-E-K%C3%8BRKES%C3%8BS-P%C3%8BR-KANDIDATURA-NGA-RADH%C3%8BT-E-GJYQTAR%C3%8BVE-P%C3%8BR-KOMANDIMIN-N%C3%8B-ZYR%C3%8BN-E-INSPEKTORIT-T%C3%8B-LART%C3%8B-T%C3%8B-DREJT%C3%8BSIS%C3%8B.pdf>.

Gjithashtu në konsultim të faqes zyrtare të KLP-së, përsa i përket kërkesës së dërguar nga ana jonë për komandim në ILD, në njoftimin e datës 20.10.2023 të mbledhjes plenare, KLP ka marrë vendimin: *“Për mosmiratimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për hapjen e procedurës për komandim të prokurorëve pranë kësaj strukture”*, me arsyetimin se ka vakanca të shumta në sistem dhe se deri më sot 5 prokurorë janë komanduar nga KLP-ja në ILD¹³.

KLP me shkresën e saj nr. 2007/1 datë 30.10.2023, ka parashtruar argumentet për arsyet e mosmiratimit të kërkesës, pasi është në pamundësi për komandimin në ILD të prokurorëve përtej numrit tashmë të caktuar prej 5 prokurorëve, duke vlerësuar prioritare garantimin e vijueshmërisë së punës në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale nga organi i akuzës. Arsyet e pamundësisë së komandimit lidhen me situatën aktuale të numrit të reduktuar të prokurorëve në sistem, për shkak të vakancave të krijuara si rrjedhojë e procesit vetting, i cili ka sjellë për pasojë një ngarkesë tepër të lartë të procedimeve në trajtim për secilin prokuror. Gjithashtu duke marrë parasysh edhe kriterin ligjor, të parashikuar në nenin 47, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, se magjistrati i komanduar pranë ILD-së duhet të ketë 13 vite eksperiencë në punë, Këshilli vlerëson se, shkëputja nga sistemi e cilitdo prokuror me përvojë në këto rrethana do të sillte vështirësi të konsiderueshme në mbarëvajtjen e punës së përditshme.

Në përgjigje të kësaj shkrese Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 2459/3, datë 27.12.2023, i është drejtuar KLP-së në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional dhe ka kërkuar rishpalljen e procedurës për komandim me qëllim plotësimin e organikës së institucionit, duke theksuar rëndësinë e përmbushjes nga ana e KLP-së të detyrimit ligjor dhe nisjen e procedurave për komandimin e dy magjistratëve prokurorë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka parashtruar se lidhur me vlerësimin e bërë për pamundësinë e komandimit të prokurorëve në ILD, duke argumentuar mbi reduktimin e numrit të prokurorëve në sistem, ngarkesës tepër të lartë të tyre dhe kriterit të përvojës 13 vjeçare në profesion dhe problematikave që do të mund të sjellë komandimi i tyre, theksojmë se kriteret për komandim në ILD, janë kriteret të përcaktuara me ligj, sikundër është edhe kriteri i përcaktuar në nenin 209, pika 1 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, se për ushtrimin e veprimtarisë kushtetuese e ligjore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjysma e inspektorëve duhet të jenë magjistratë, të cilët komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Vlerësimi i nevojave për komandim të magjistratëve në institucione, duhet të jetë proporcional në raport me rëndësinë e ushtrimit të funksioneve dhe peshën që zë komandimi në ushtrimin e funksioneve. Mungesa e inspektorëve magjistratë dhe kriteri për numër të barabartë

¹³ Njoftimi mund të aksesohet në linkun vijues: <https://klp.al/2023/10/20/njoftim-per-media-mbi-seancen-plenare-date-20-tetor-2023/>

inspektorësh magistratë dhe jomagjistratë, mbart ndikim të qenësishëm në ushtrimin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në referim të argumenteve të KLP-së për numrin e prokurorëve të komanduar në ILD, është vënë në dukje se në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë komanduar gjithsej 5 (pesë) magistratë prokurorë, 3 (tre) prej tyre kryejnë detyrën e inspektorit, 1 (një) magistrat është në pozicionin e këshilltarit, ndërsa 1 (një) magistrat është shkarkuar nga detyra me vendimin nr. 426, datë 27.07.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe pritet vendimi përfundimtar nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Efektivisht në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ushtrojnë detyrën si inspektorë vetëm 3 (tre) magistratë.

5. *Forcimin e mekanizmave institucionale për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të subjekteve të procedimit disiplinor.*

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet ILD-së dhe ILDKPKI-së, me nr. 2643 prot., datë 12.09.2023 e cila ka si objekt:

1. Shkëmbimin e informacionit në lidhje me konfliktin e interesave dhe të verifikimit të deklaratave të interesave private, ndaj subjekteve të përcaktuar në marrëveshje gjatë ushtrimit të detyrës;
2. Bashkëpunimin për shkëmbimin e eksperiencave dhe përvojave mbi çështjet e deklarimit të pasurisë dhe rastet e hasura të konfliktit të interesave, duke përcaktuar modalitet, tematikat, si edhe çdo proces tjetër në kuadër të forcimit të kapaciteteve;
3. Bashkëpunimin për shkëmbimin e informacionit dhe konsultimin e akteve si rregullore, vendime, udhëzime në sferën e kontrollit të pasurisë dhe konfliktit të interesave të nxjerra nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në vijim të nënshkrimit të kësaj marrëveshje, është përcaktuar një kalendar i punës, i cili është duke u realizuar.

6. *Rritjen e kapaciteteve të inspektorëve nëpërmjet implementimit të eksperiencave dhe përvojave më të mira të institucioneve të huaja me të njëjtën fushë veprimi, me fokus përmirësimin e procesit të punës në trajtimin e ankesave, proceseve hetimore etj.*

Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, si në drejtim të rritjes e fuqizimit të kapaciteteve të Zyrës së ILD-së, shkëmbimi i praktikave më të mira të punës, pjesëmarrja në seminare, konferenca dhe aktivitete që kanë për objekt nxitjen e diskutimeve në dimensione të ndryshme, janë një prioritet i vazhdueshëm, disa prej të cilave renditen si më poshtë:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në vazhdimësi vijon përpjekjet për të gjetur dhe mundësuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të kapaciteteve njerëzore. Thellimi i bashkëpunimit me RESIJ, si me konferencat e trajnimet, ashtu edhe materialet përgatitore për të prezantuar punën e ILD-së, kanë ndikuar në krijimin e partneritetit profesional ndërkombëtar të Zyrës

së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke shënuar një tjetër arritje të rëndësishme, atë të pranimit unanim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si anëtar me të drejta të plota në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ), gjatë Asamblesë së Përgjithshme së thirrur nga vendet anëtare datë 19.10.2023.

Në kuadër të vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme në datë 19 tetor 2023, nën kujdesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe me pjesëmarrjen e delegacioneve të inspektorateve të Drejtësisë të Rumanisë, e cila mban presidencën e RESIJ, të Francës, Italisë, Belgjikës, Bullgarisë, Spanjës e Portugalisë, në Tiranë, në 14 dhjetor 2023, u mbajt për herë të parë Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ). Në Asamblenë e Përgjithshme të RESIJ, anëtarët miratuan ndryshimet finale në Statutin e Rrjetit, si dhe diskutuan mbi projektet e ardhshme të RESIJ. Gjatë Asamblesë së Përgjithshme u diskutua mbi projektet e të ardhmes dhe dinamikat e organizimit dhe funksionimit të Rrjetit përmes shkëmbimit dhe ndarjes së eksperiencës metodologjike të inspektimit dhe angazhimit në sfidat e përbashkëta si pavarësia e magistratëve dhe pritshmëria e publikut nga sistemi i drejtësisë.

Në 13 dhjetor 2023, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u bë pjesë e seminarit rajonal mbi proceset e hetimit dhe teknikat e intervistimit hetimor, i organizuar në Vjenë nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) me mbështetjen e Republikës Federale të Gjermanisë, me pjesëmarrjen e ekspertëve të zbatimit të ligjit e të drejtës penale nga Evropa Juglindore, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Turqia dhe Ukraina. Inspektorët e ILD-së bënë një paraqitje të rolit dhe funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe zhvillimin e hetimit disiplinor, në drejtim të procedurës së intervistimit të magistratëve, dëshmitarëve dhe çdo personi tjetër që mund të ketë informacion rreth fakteve objekt i hetimit disiplinor. Prezantimi i përfaqësuesve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përfshiu bazën ligjore dhe metodologjinë e parashikuar në legjislacionin shqiptar për zhvillimin e procesit të pyetjes.

Në 13 nëntor Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkë me krerët e disa organeve të pavarura zhvilloi një vizitë pune në SHBA, me ftesë të Open Gov Hub USA, së bashku me kolegë nga institucione të tjera të drejtësisë së Shqipërisë. Gjatë vizitës, u organizua event publik me temë “Reforma në drejtësi në Shqipëri, konstitucionalizmi në veprim”, mbi të cilën ndanë mendimet e tyre, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami dhe Kryetari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, z. Roland Ilia, të cilët më pas iu përgjigjën pyetjeve të audiencës. Duke folur për gjetjen e ekuilibrit të duhur, midis një qeverisjeje të qëndrueshme, solide dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, z. Metani bëri krahasimin me mënyrën e punës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në 1 nëntor 2023, si pjesë e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ), Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka pranuar ftesën e Rrjetit për t’u angazhuar në projektin

COPEIJ, të Komisionit Evropian “Për bashkëpunimin në mbrojtjen e mjedisit përmes autoriteteve kombëtare të inspektimit të drejtësisë”, përkrah institucioneve homologe të Francës, Italisë, Rumanisë dhe Portugalisë, nën menaxhimin e Expertise France. Në këtë kuadër, anëtarë të Zyrës së ILD-së kanë marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e projektit të zhvilluara në periudhën shkurt-shtator 2023, që nga takimet koordinuese tek vizitat studimore, që janë kryer me rotacion në secilin nga vendet e projektit, e gjatë të cilave autoritetet kombëtare vendase, përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, kanë referuar praktikatat e punës dhe sfidat si institucionale ashtu edhe ligjore. Në përfundim të kësaj faze, është hartuar raporti i punës, në gjuhën frënge, me panoramën dhe rekomandimet për autoritetet kombëtare dhe Komisionin Evropian, për krijimin e mjeteve për reduktimin e hendekut mes nevojës për drejtësi penale efektive mjedisore dhe realitetit aktual në secilin vend¹⁴.

Në kuadër të vizitës zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm Francez të Drejtësisë në datat 01-02 qershor 2023 me Inspektorët, Ndihmës Inspektorët, Kabinetin, Sekretarin e Përgjithshëm, dhe Drejtorinë e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është kryer trajnimi mbi inspektimet dhe metodikën e punës së shërbimit francez të inspektimit. Ky aktivitet është realizuar në kuadër të bashkëpunimit me RESIJ dhe me mbështetjen e CEPEJ, projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës për Drejtësinë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është ftuar në Shkollën e Magjistraturës për të trajnuar mbi tematikën: “Shkeljet disiplinore dhe llojet e tyre sipas ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, i ndryshuar”. Kriteret e caktimit të rëndësisë së shkeljes disiplinore të magjistratëve, në fokus të individualizimit të masave disiplinore në rastet konkrete. Llojet e masave disiplinore dhe vendimmarrja e Këshillit, ndërvarësia e procedimeve disiplinore të filluara në KLGJ me procedurat disiplinore të filluara nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Në muajin shkurt 2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani me ftesë të Këshillit të Shtetit të Greqisë, ka zhvilluar një vizitë pune në Athinë, dhe ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi në respekt të interesit të përbashkët për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë. Ky memorandum parashikon bashkëpunimin mes palëve duke shkëmbyer informacione, praktika dhe përvoja në lidhje me të gjitha aspektet procedurale të kryerjes së një hetimi disiplinor dhe procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve¹⁵.

¹⁴ Ky raport gjendet i publikuar në linkun vijues: <https://ild.al/sq/2023/11/01/raport-kombetar-i-ild-bashkepunimi-per-mbrojtjen-e-mjedisit-nga-autoritetet-kombetare-te-inspektimit-te-drejtësisë-copeij/>

¹⁵ Memorandumi gjendet në linkun <https://ild.al/sq/2023/02/02/inspektori-i-larte-i-drejtësisë-nis-bashkepunimin-me-keshillin-e-shtetit-te-greqisë/>.

- 7. Bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm për përcaktimin e çështjeve për inspektimet tematike me synim rekomandimin për standarde të njëjta në proceset hetimore, gjyqësore dhe respektimin e të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit.*

ILD ka iniciuar kërkesat drejtuar KLGJ, KLP, PP dhe MD, për paraqitjen e tematikave për inspektim për t'u përfshirë në planin vjetor të inspektimeve për vitin e ardhshëm, duke vendosur datën 22.12.2023, si afatin për paraqitjen e kërkesave të tyre. Deri në afatin e vendosur, ka kthyer përgjigje KLGJ-ja, e cila informon se në ditët në vijim do të paraqesë tematikat. Me shkresën nr. 1854/1 prot., datë 26.12.2023, Prokurori i Përgjithshëm ka përcjellë propozimet e tij për inspektimet tematike, ndërsa institucionet e tjera nuk kanë paraqitur propozime.

Plani vjetor i inspektimeve realizohet duke marrë në konsideratë problematikat e evidentuara nga shqyrtimi i ankesave, vlerësimin e pretendimeve më të shpeshta për shkelje të ndryshme nga ana e magjistratëve, administratës së gjykatave apo prokurorive, propozimeve të ardhura nga institucionet si dhe në mbështetje të dispozitave të zbatueshme për inspektimet. Plani vjetor i inspektimeve do të caktohet në janar të vitit 2024. Plani miratohet pasi i është nënshtruar diskutimeve të Mbledhjes së Përgjithshme të inspektorëve dhe pas vlerësimit objektiv dhe real të mundësive dhe kapaciteteve njerëzore e financiare që disponon ILD.

Deri në muajin dhjetor 2023 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar 4 inspektime dhe është në proces të kryerjes së inspektimeve tematike të planifikuara pranë gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Synimi primar i këtyre inspektimeve tematike, ka qenë konstatimi i problematikave në sistem dhe rekomandimi i zgjidhjeve, të cilat pritet t'i shërbejnë përmirësimit të punës së prokurorive dhe gjykatave.

Konkretisht, në lidhje me inspektimet, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer katër inspektime tematike që kanë patur si objekt:

1. Evidentimin e mënyrës së interpretimit, respektimit të kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, nga prokurorët. Në përfundim të inspektimit janë nxjerrë rekomandime për organet kompetente për të marrë masa me karakter rregullator, përmes ndryshimeve ligjore dhe nxjerrjes së akteve nënligjore në kompetencë të tyre për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”. Njëkohësisht janë propozuar edhe masa të karakterit administrativ, duke propozuar sesione trajnimi për garancitë kushtetuese e konventore të lirisë

personale, unifikimit të praktikave në të gjitha prokuroritë dhe rritjen e cilësisë së magjistratëve, përmes ofrimit të trajnimeve vazhduese¹⁶.

2. Zbatimin e urdhrave të Prokurorit të Përgjithshëm, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë së organit të prokurorisë përmes kohezionit institucional dhe uniformitetit të veprimtarisë në të gjitha prokuroritë, në garantimin e pavarësisë funksionale të prokurorit në vendimmarrjen për çështje konkrete¹⁷.
3. Vlerësimin e praktikave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me zbatimin e kriterëve ligjore mbi shpalljen dhe depozitim të vendimeve gjyqësore të arsyeuara në sekretari. Në përfundim të inspektimit janë nxjerrë rekomandime për organet kompetente për të marrë masa me karakter administrativ dhe zbatimit të kërkesave procedurale për njoftimin e vendimeve përfundimtare, jo përfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit nga Kodi i Procedurës Civile. Gjithashtu janë nxjerrë rekomandime për fillimin e verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor ndaj disa magjistratëve¹⁸.
4. Trajtimin e kërkesave për “Lirim me kusht” nga ana e gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre, në lidhje me zbatimin e ligjit material/procedural në fuqi. Ky inspektim ka sjellë efekte të ndjeshme në kuadër të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së magjistratëve, duke konkluduar në hetime dhe procedime disiplinore ndaj disa magjistratëve, për të cilët edhe Këshillat kanë pranuar kërkesën e ILD-së duke i shkarkuar nga detyra¹⁹.

Në përfundim të këtij inspektimit ILD ka hartuar disa rekomandime për prokuroritë dhe gjykatat subjekt inspektimi, Gjykatën e Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës dhe afati për monitorimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve është vendosur nga data 01.04.2024-01.10.2024.

¹⁶ Informacionin mbi këtë inspektim e gjeni në linkun: <https://ild.al/sq/2022/11/11/raport-i-inspektimit-mbi-respektimin-e-kushteve-dhe-kriterëve-per-aktimin-e-masave-te-sigurimit-personal-per-vepren-penale-te-mbajtjes-pa-leje-dhe-prodhimit-te-armeve-armeve-shperthyes-dhe-munici/>

¹⁷ Informacionin mbi këtë inspektim e gjeni në linkun :<https://ild.al/sq/2023/01/17/raport-per-krerjen-e-inspektimit-tematik-te-prokurorive-te-juridiksionit-te-pergjithshem-me-objekt-mbi-marrjen-e-masave-administrative-dhe-procedurale-ne-kuader-te-zbatimit-te-udhezimit-te-per/>

¹⁸ Raportin e gjeni në linkun vijues: <https://ild.al/sq/2023/10/04/raport-i-inspektimit-mbi-proceduren-e-shpalljes-dhe-arsyetimit-te-vendimeve-gjyqësore-te-gjykates-se-shkalles-se-pare-te-juridiksionit-te-pergjithshem-tirane-dhoma-civile-dhe-gjykates-administrat/>

¹⁹ Raportin e gjeni në linkun vijues: <https://ild.al/sq/2024/02/22/raporti-i-inspektimit-mbi-krerjen-e-inspektimit-tematik-te-gjykatave-dhe-zyrave-te-prokurorive-prane-tyre-mbi-trajtimin-e-kerkesave-me-objekt-lirim-me-kusht/>